REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.1325 Prot

Maliq, më 02.03.2026

VENDIM
Nr. 26, datë 27.02.2026

"Për miratimin e proces verbalit të datës 30.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 8, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 88, i Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 30.01.2026 bashkangjitur.

2.Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.03.2026

NË MUNGESË

DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT

Enida AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.01.2026 Prot.50 (pesëdhejtë)

Protokoll nr. 50

I mbajtur sot më datë 30.01.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari;Idlir Limllari; Fevri Sherifi; Pranvera Begolli; Enida Avdolli; Petrit Kupe; Danjela Ibrahim; Gentiana Drabo;Floreta Zaçe; Aramando Dautllari; Marinathi Avrami; Selami Muço;Kristina Malelli; Plator Çollaku; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Neresida Shindo; Dalina Krekas; Almir Elezi; 22(njëzetëenjë) këshilltarë.

Mungesa: Andonaq Risto; Dritan Çami; Klea Baçi; Rovena Terolli; Albina Xhejo; Xhuana Hoxhallari; Eriseld Jonusllari; Ilia Xhuti; Marjeta Xhelollari; 9 (nentë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti;Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli.

Ornildi Demollari: Mirë fillojmë, mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar kryetarë i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës. Po fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliqit, sikurse kemi njoftuar. Fillimisht, të verifikojmë korumin. Korumi realizohet pasi janë 21 këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë me mbledhjen dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por ajo çfarë ne kemi marrë në rendin e ditës ka dhe dy pika të tjera shtesë, të cilat na kanë erdhur dje. Dhe janë dakordësuar në komisionet përkatëse dhe mendoj që mund t'i shtojmë rendin e ditës nëse këshilli bie dakord. Kush është dakord me rendin e ditës, duke shtuar dy pikat e djeshme? 22 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, saktësisht mbledhjes së datës njëzetë e katër, dhjetor dy mijë e njëzetë e pesë. Janë gjithsej shtatë shtatë vendime me karakter normativ, por në këto shtatë. Tre prej tyre janë kthyer nga institucioni i prefektit, të cilat kaluan pastaj në mbledhjet jashtë radhe dhe në mbledhjen e datës tetë janar. Mbledhja e datës tetë janar, se mbledhja e datës dymbëdhjetë ishte mbledhje informuese. Konkretisht, është vendimi me numër njëqind e dyzetë e shtatë, i cili të nuk u konfirmua nga Prefekti, pasi kalonin datën tetë janar. Vendimi me numër njëqind e dyzetë e tetë dhe vendimi me numër njëqind e pesëdhjetë, nuk u konfirmuan nga Prefekti dhe e kaluan në mbledhjen e datës tetë janar. Janë dhe shtatë vendime me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime tashmë. Ju i keni mund t'i shikoni kështu që. Më lejoni t'ju njoh me, t'ju rikujtoj konfliktin e interesit, nderuar kolegë. Nëse ndonjëri nga ne ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës, është mirë që në atë pikë. të mos përfshihet as në diskutim, as në votim. Dhe ju ftoj tani të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar, mbledhja. Mbledhjes së kaluar, kush është dakord me protokollin e mbledhjes së kaluar? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka. Miratohet protokolli i mbledhjes. Faleminderit. Kalojmë tek pika e katër e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin dhjetor dy mijë e njëzet e pesë. Kush e do fjalën tek pika katër?

Faslli Zholi: Po, përshëndetje të gjithë këshilltarët, kryetari i bashkisë, pjesëmarrës. Dua të sqaroj pika katër për miratimin e ndihmës ekonomike. Ne komunikuam me nënkryetaren Zonjën Genta dhe unë isha pjesëmarrës dhe në ekzekutivin. I pamë ato, bëmë edhe nja dy pyetje, të cilat janë të dokumentuara. Mendoj që ta miratojmë ndihmën e muajit dhjetor dy mijë e njëzet e pesë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kështu do fjalën tek pika katër. E kalojmë në votim?
Kush është dakord me pikën katër kundër? 22 vota pro.
Nuk ka abstenim.
Kundra?Nuk ka.Miratohet me Faleminderit. Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës për vendim për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Kështu do fjalën, mbledhjet e komisionit. Po
Faslli Zholi: edhe në pikën pesë, për miratimin e kriterëve, neve bëmë sugjerimet tona, duke kërkuar aty që të. Do ta them edhe në pikën gjashtë, të cilën kemi një. Diçka për të shtuar dhe do ta shprehim mendimin tonë. Këtu duhet patur kujdes dhe çupës, i thashë që t'i shikojnë mirë këto ndihmat ekonomike, se gjithmonë kemi patur probleme të cilat. Njerëzit dhe ankimet kemi patur nga më të ndryshmet. Gjithsesi, unë shpreh votën pro për ta miratuar mbas atyre që neve pamë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë? Koment këtu. Po.

Yllson Ibrahimllari: Unë mendoj që komisionet tashmë kanë të nderuar kolegë. Unë besoj që komisionet tashmë kanë pjekurinë e nevojshme. Janë në vitin e tretë të mandatit. Besoj dhe pak

kohë ka ngelur për ta mbyllur mandatin vetë. Ne nuk do të pranojmë më as firmosje, as mosprezencë në komisione, as do të kalojmë në rendin e ditës. Është mbledhja e fundit që bëjmë këtë gjë. Pa paraqitur relacione nga grupet respektive, ju lutem, siç keni respekt për veten. Duam edhe që t'ju respektojmë juve. Faleminderit.

Orildi Demollari: Faleminderit, ka ndonjë gjë tjetër? E kalojmë votim?
Kush është dakord me pikën pesë 22 vota pro
Kundër? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka me njëzet e dy vota, pro miratohet pika pesë. Faleminderit, kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, projekt vendim për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë.

Faslli Zholi Në pikën gjashtë, ne mendojmë që të na bazë të kërkesave dhe ankesave që kemi nga shumë qytetarë. Këtu bëhet fjalë jo për ndihmat e gjashtë për qind, por bëhet fjalë për ndihmat e tjera të cilat janë ndaluar me ligj, siç na thotë që ne nuk duhet t'i shikojmë. Që kjo është tjetër gjë, diçka unë mendoj për të qenë sa më transparent të ngrihemi një komision. Verifikimi në bazë institucionale të ish-njësive vendorë dhe si bashki. për të bërë një transparencë me qëllim që edhe vetë institucionet përkatëse që merret me këtë punë të jenë të qartë, po dhe qytetarë të cilët ta thonë që merr Fazlliu dhe nuk merr iksi. Ku janë në të njëjta kushte, mbase janë edhe më të këqija, siç na thonë qytetarët. Neve i shprehim këto, po do të thotë dikushi që pse dëgjoni vetëm qytetarët, ne qytetarët do dëgjojmë të parët. Dhe ata, siç na thonë ata, neve për ta verifikuar këtë, për të shuajtur edhe etjen e shumë gjëra, mendoj që të ngrejmë një komision verifikimi që a janë zbatuar kriteret për këtë pikë. Këto kisha unë, ju faleminderit.

Orildi Demollari: Ka ndonjë gjë tjetër, kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë mendoj ta miratojmë si projekt vendim, pastaj verifikimet e këshillit apo të komisionit, si e mendojnë ju, s'kanë asnjë problem për ne. Le të verifikohen, jo vetëm për këtë rast, kini të drejtë të verifikoni për të gjithçka. Por kriteret, besoj, do i keni parë ju. Ato janë kritere që miratohen vit pas viti. Dhe besoj që jemi në linjën e plotësimit të disa kritereve që ne. Përdorim këshilli, i miraton pastaj rast pas rasti sipas nevojave që ka. T'i kalojmë dhe mos krijojmë problem për drejtorinë përkatëse.

Orildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë tjetër? E kalojmë votim pikën gjashtë.?
Kush është dakord 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka me njëzet e një vota pro miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projekt vendim. Për miratimin e bursave të nxënësve ekselentë që ndjekin studimet në shkollat e mesme të Bashkisë Maliq për vitin shkollor 2025-2026. Komisioni Nërsida, po, po, përshëndetje të gjithëve.

Nersida Shindo: Lidhur me pikën shtatë të rendit të ditës për bursat e ekselencës. Unë i mbështes të gjithë nxënësit, megjithëse më duken pak. Shpresoj që të motivohen nga këto bursa dhe të kemi sa më shumë nxënës që e meritojnë ta marrin. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Ka një gjë tjetër këtu, e kalojmë votim?
Kush është dakord? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? nuk ka. Mirotohet, faleminderit dhe suksese nxënësve. Kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e përfituesve nga programi subvencionimi i qerasë për strehimin.
Idlir Limllari:Komisioni janë katër familje që përfitojnë pas pikëzimit. Paguhen nga janë brenda rregullave, vendosim të miratohen.komisioni përdje.
Ornildi Demollari: Po sugjeroni të miratohen. Kemi gjë tjetër? Kush është dakord e kalojmë votim? Kush është dakord? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me njëzet e një vota pro miratohet. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës, projektvendim për përjashtimin nga pagesa e qerasë sociale për familjet e strehuara në banesën sociale pranë ish-laboratorit.

Idlir Limllari: Janë tre familje aty që paguajnë një qira. Ajo qira ia kalon për mirëmbajtje, meqënëse këta i mirëmbajnë vetë ato. Një pjesë nuk paguajnë, janë të Komitetit Romë. Tre familje paguanin qira simbolike, mirëpo këto u kalonin për mirëmbajtje, meqënëse ata i mirëmbajnë vetë. Kot sa ti marrim në qiranë, vetëm të herë pas here t'i kontrollojmë. Nga punonjësi i bashkisë, që të mirëmbahet në kutinë.

Ornildi Demollari: Pra, gjykoni që të mos të përjashtohem nga ajo tarifë e vogël.

Idlir Limllari: Tarifa është simbolike.

Ornildi Demollari:Është diçka. Kryetar, ke gjë për të shkuar apo ta kalojmë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nuk kam, jam shumë dakord me propozimin e fundit që ne duhet ta ndjekim situatën në vazhdimësi, që ajo godinë mos degradojë, sepse është investuar dhe atyre u shërben. Por duhet parë nga ana jonë dhe në qoftë se do të kemi problematika, atëherë. Do të rikthejmë qiranë që ne ta mirëmbajmë, të ketë jetëgjatësi sa më të gjatë. Dhe zyra, besoj, zyra e shërbimit social, drejtoria e strehimit. Zyra e strehimit duhet ta ndjekë në mënyrë periodike.
Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë tjetër, e kalojmë votim. Kush është dakord? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka me njëzet e një vota pro. Miratohet pika nëntë faleminderit. Kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës, projektvendim për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

për periudhën kohore dy mijë e njëzet e shtatë, dy mijë e njëzet e nëntë. Komisioni i financës. **Petrit Kupe:**Përshëndetje, Jemi dakord me miratimin e dy prej vendimeve radhë, mos e marr fjalën dy herë. Për projketvendimin e parë është një parashikim që kryhet në fillim të çdo viti. Një projekt i parashikimit të ardhurave për vitet e ardhshme, si procedurë, dërgohet pranë Ministrisë Financa në kuadër të parashikimit të buxhetit të bashkisë. Zyra e të ardhurave ka miratuar në perspektivë të ardhurat sipas zërave, duke parashikuar një rritje modeste në vitet e ardhshme. Jemi dakord që të, meqënëse të ardhurat, siç e dini, janë ato nivele, ky plan është. Ky plan është aq sa është rritur dhe është i mjaftueshëm, pasi pse të ardhurat e dini që realizojnë në nivelin deri në gjashtëdhjetë për qind. Synohet që mund të arritni edhe më tej, por më duket si një rritje fiktive. Kështu që të miratojmë këtë projekt dhe të bëjmë përpjekje për të rritur të ardhurat nga viti në vit, siç ka ardhur. Këtë jemi dakord ta miratojmë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kryetar, ndoshta është diçka tek unë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po, është një procedurë standarde për të cilën ne parashikojmë një realizim të të të ardhurave në tre vitet e ardhshme buxhetore, kështu që besoj dhe shpresoj që këshilli ta miratojë dhe ne të synojmë të rritim në maksimum të ardhurat. E buxhetit të pavarur, pasi janë bazë për shërbime për investime. Ne paralelisht me këtë, shumë shpejt do të sjellim edhe disa projektvendime të tjera që kanë të bëjnë me përmirësimin e vjeljes së të ardhurave dhe me krijimin dhe ndarjen e një pjesë të grumbullimit nga agjentë tatimorë, siç është ndërmarrja e ujësjellësit të ujësjellës kanalizimeve, por ky është një moment tjetër dhe shpresojmë që të k të punojnë paralelisht me dy zona, edhe me debitorët ndër vite, por edhe me vjeljet e buxhetit të kalendarik buxhetor.

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë votim?
Kush është dakord? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
abstenim, nuk ka. Miratohet me njëzet e një vota pro. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës, që është projektvendim për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej njëzet metra katror. Në ngastrën me numër tridhjetë e nëntë të ekonomisë pyjore Moglicë, fshati Gurë Shqipe, njësia administrative Moglicë, bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një. antenë telefonike nga kompania Vodafone Albania Sh.a.

Petrit Kupe: E vlerësojmë këtë pretendim. Për shkak të përpjekjeve të vazhdueshme që është bërë nga ana e bashkisë dhe nga kërkesa e komunitetit që jeton në atë zonë, sepse nuk mbulohen me valë të Vodafonit, më tepër kjo ka rëndësi se sa të ardhurat që ndaj realizohen në një sipërfaqe prej njëzet metër katror. Ndoshta me vonesë, por është një investim i domosdoshëm dhe patjetër duhet ta mbështetim. E sugjerojmë që në projket-vedim të pasqyrosh edhe sa të ardhura realizon bashkia për të njëzet e katër m2. Më duket se këtë vërejtje kemi bërë në disa projektvendime të tjera. Po siç duket, hartuesit e këtij projektvendimi nuk janë rekorduar me zyrën e të ardhurave për një llogaritje të thjeshtë. Sa i vjen në ndihmë buxhetit të bashkisë dhe

qiraja e këtij njëzet metër katror, jemi dakord që të miratohet. Ndoshta mund ta jepni ndonjë përgjigje për këtë që pyet.

Ornildi Demollari: Po, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po vërtja është me vend, mendoj që në mbledhjen e radhës ne t'u sjellim informacion jo vetëm për këtë, po për çdo antenë celulare në varësi të vendit të madhësisë të sipërfaqes që kanë marrë dhe të kompanive që operojnë. Ndoshta kjo duhet të jetë një praktikë pune për çdo projektvendim që krijon të ardhura, që këshilli të njihet. Kështu që është një vërejtje mekanike. Dhe besoj, dhe besoj, dhe shpresoj që duhet të ketë një rekordim më të mirë, edhe për këto që jep porosi nga ana e sekretarit të këshillit. Se jo çdo gjë që mbajmë shënim ndonjëherë shkon tek zyrat. Por Gerti duhet ta ndjekë këtë porosi që jepet, t'ju jepet pavarësisht se këtu është prezent edhe. Përgjegjësi i sektorit të pyekullotave, i cili në një farë mënyre mban edhe ai evidencën e të ardhurave që sigurojnë, duke raportuar me drejtorinë e të ardhurave. Por nuk flas vetëm për këtë projektvendim, kjo të jetë si një praktikë pune për çdo projektvendim që i krijon të ardhura në buxhetin e bashkisë.

Ornildi Demollari: Faleminderit..

Yllson Ibrahimllari: Dhe në vazhdim të problematikës së ngritur, do doja të shtoja që ne nuk kemi këtu zyra të ndara. Ne kemi një trup që quhet administrata ekzekutive. Për këtë arsye, na jepet një hartografi. E nxjerr nga Google me një numër pasurie dhe me dy koordinata iks ypsilon. Do të mendoja dhe do të sugjeroja pastaj vendimin që ju takon juve, që pavarësisht punës së mirë të bërë nga sektori Pyje-kullota apo Drejtori, si e keni titulluar tashmë, edhe ne bashkë e kemi marrë atë vendim. Që ka dhe drejtori të tjera të cilat mund të koperojnë. Unë besoj që kontratat e qerasë duhet të kenë një Gentplan, shoqëruar në kuptimin topografik e mire përcaktuar sipërfaqja e cila do të jetë, e sigurisht që këtu mund të jetë simbolike se janë njëzet metra. Por dhe sipërfaqet e tjera mund të mos citohet vetëm pjesa e parcelës pyjore, por të ketë edhe një. Gentplan nga topografi i bashkisë, që këto janë koordinatat që të mos japin në të ardhmen konflikte të mundshme pronësore ose problematika me banorët. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit tek kjo pikë. Këshillit ka erdhur një kërkesë e firmosur nga banorët e zonës, të cilët e shikojnë të nevojshme. Ndërtimin e një antene të kompanisë celulare atje, plus kësaj, unë individualisht kam zhvilluar një takim me banorët e fshatit Gush Shqipe. Po ashtu, edhe domethënë si në shkresë, edhe aty në takim ata ishin dakord që të ndërtohet antena, sepse e kanë të nevojshme. Desha vetëm ta pyesja. Klarsenin që kompania, besoj ka bërë matje atje, e mbulon zonën me atë, e arrin ta mbulojë me valë.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota Klarsen Brako: Kisha thënë më atje para dy vitesh, e kisha kaluar edhe një herë para dy vitesh. Po përjashtoj sepse nuk do ta thajë në fund edhe një mijë kuota, sepse më bënte shumë të pakta. Domethënë,

Ornildi Demollari: Kjo është për atë, këtë, kjo ishte për Yllsonin apo jo? Po, jo, të lutem, ata kanë sjellë kështu një raport matjesh. Kanë bërë matje, besoj. Dakord, mirë, faleminderit. E kalojmë votim, atëherë kush është dakord? 22 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim?Nuk ka. Miratohet faleminderit me njëzet e një vota pro. Kalojmë tek pika dymbëdhjetë e rendit të ditës, që është projektvendim për ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit nëntor dy mijë e njëzet e pesë në rrugën e fshatrave Velçan, Selcan, Mesmal, NJ.A administrative Gorë, Bashkia Maliq.

Pranvera Begolli: Aktualisht, komisioni i rregullores dhe i ligjeve u mblodh. Dhe ra në një unison të përbashkët që të mbetet në rendin e ditës. Por pas debateve atje, unë për vete po ngrej mendimin tim personal që ne të merremi me një komision hetimor, duhet të jemi kompetentë. Të jemi njerëz që janë marrë me çështjet penale, me ndjekjet penale, dhe kjo për mua i përket dikujt tjetër. Dimë që janë ankuar edhe tek avokati i popullit dhe prokuroria. Kështu që unë jam kundër. Për ngritjen e këtij komisioni, shpreh mendimin tim personal. Nuk e di çfarë më thonë kolegët.

Ornildi Demollari:Për arsye sepse ajo çështje, nuk jemi kompetentë ne.

Pranvera Begolli: Unë mendoj që brenda administrata mund të marri të. Që ka pjesën e saj juridike. Ne si këshilltarë nuk besoj se plotësojmë kuotat e nevojshme apo amendamentet e nevojshme për të qënë ne përfaqësues të një komisioni hetimor. Për përmbytjet apo për, si këtu thotë për përmbytjet e nëntorit? E kuptoj.

Ornildi Demollari: Po, po, kemi gjë tjetër atë.

Yllson Ibrahimllari: Sekretari të lexojë kërkesën për ngritjen e komisionit. Ju mund të abuzoni, kryetari të lexojë ç'arje është dërguar me firmë. Nga grupi i këshilltarëve, ne si komisioni i mandateve mund të shprehemi. Që është konform ligjit dhe rregullores, ose jo, nuk kemi të drejtë ne të shprehim për gjëra të tjera. Mendimi individual kur të fillojë seancën.

Ornildi Demollari:Kërkesë për ngritjen e komisionit të përkohshëm hetimor, drejtuar kryetarit të Këshillit Bashkiak, në mbështetje të nenit pesëdhjetë e tretë të ligjit njëqind e tridhjetë e nëntë dy mijë e pesëmbëdhjetë, përveç qeverisë vendore. Neni gjashtëmbëdhjetë pika një të rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak me ligj, që përcakton rolin përfaqësues vendimarrës dhe mbikëqyrës të Këshillit Bashkiak. Neni njëzet e pesë të rregullores që sanksionon ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e kryetarit dhe administratës së bashkisë, shtojca me numër tetëmbëdhjetë komisioni i përkohshëm hetimor pë pjesëpërbërëse e rregullores së organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak, si dhe në ushtrim të drejtës ligjore të këshilltarëve bashkiak, ne këshilltarët bashkiak nënshkrues. Kërkojmë ngritjen e komisionit të përkohshëm hetimor. Baza ligjore e ngritjes së komisionit në përputhje me shtojcën numër tetëmbëdhjetë të rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq. Komisioni i përkohshëm hetimor krijohet me kërkesë të një të katërt të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Bashkiak për

verifikimin apo hetimin e një çështje të caktuar, kjo kërkesë paraqitet nga një numër këshilltarësh që përmbush kriterin minimal ligjor për inicimin e komisionit. A duhet të vlen ta çojmë deri më poshtë në fund? Objekti i komisionit të përkohshëm hetimor në përputhje me pikën një të shtojcës numër tetëmbëdhjetë, objekti i komisionit hetimor të jetë. Një verifikim dhe hetim i gjendjes së rrugëve të fshatrave në territorin e Bashkisë Maliq, duke shqyrtuar planifikimin dhe programimin e investimeve, burimet e financimit, procedurat e Prokurimit publik, zbatimin e kontratave dhe cilësinë e punimeve, përputhshmërinë e proceseve dhe rezultateve me objekte zhvillimore të bashkisë. Hartimi i problematikave të përsëritura të përmbytjeve në fshatra të veçantë, Selc, Mesmal, duke analizuar shkaqet teknike, hidrologjike dhe infrastrukturore. Masat parandaluese të ndërmara ose të pa mara nga administrata e bashkisë Maliq, efektiviteti i investimeve publike të realizuara, përgjegjësitë institucionale dhe administrative për situatën e krijuar, qëllimi i komisionit të në përputhje me pikën një të shtojcës numër tetëmbëdhjetë, komisioni ka për qëllim mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit përkatës. Hetimin e përpushmërisë në procese dhe rezultatet me standarde dhe objektivat e miratuara, evidentimin e abuzimeve apo keqpërdorimeve të fondeve dhe autoritetit nëse ka, formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e procedurave të cilësisë së shërbimeve dhe qeverisjes vendore. Pika katër, përbërja dhe funksionimi në zbatim të pikës dy të shtojcës numër tetëmbëdhjetë, komisioni të përbëhet nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë këshilltarë gjithmonë me numër tek. Përbërja të sigurojë përfaqësim sa më të balancuar të shumicës dhe opozitës. Kryetari i komisionit t'i përgatisë grupit nismëtar të krijimit të komisionit. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me rregulloren e Këshillit Bashkiak Maliq. Pika pesë afati dhe raportimi në përputhje me pikën tre të shtojcës numër tetëmbëdhjetë, grupi nismëtor propozon që afati i veprimtarisë të komisionit të jetë gjashtëdhjetë ditë nga data e konstituimit. Në përfundim të hetimit, komisioni paraqet raport përfundimtar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për shqyrtimin dhe vendimarrjen. Pika gjashtë kërkesë për përfshirjen në rendin e ditës në zbatim të rregullores së Këshillit Bashkiak. Kërkojmë që kjo kërkesë të përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim nënshkruesit. Janë kryesisht, jo kryesisht, po të gjithë këshilltarët e opozitës. Kjo është kërkesa, po.

Yllson Ibrahimllari: Tani besoj që më vjen radha, duke qenë banor i Vëlçanit dhe i zonës, për të mbajtur një ekspoze të qartë. Përsa i përket që vetë këshilltarët dhe ekzekutivit janë të qartë mbi problematikë, ju lutem të dalë për çfarë e ke. që ishte e rëndë në dhomën e murit, mora një kryetar dhe mendoj që të lexoj një problematikë të mundshme të sqarojë, të nderuar qytetarë, të nderuar kolegë, i nderuar kryetari i bashkisë Maliq. Më lejoni të deklaroj se megjithëse jam banor i Velçanit, nuk dua që të trajtohet asnjë gjë e problematikave të pronave të mia, në nismën e këtij komisioni, këtu ka lidhje me pronat dhe jetësën e qytetarëve të njësisë administrative Gorë, Bashkia Maliq, për të cilat në dy muajt e fundit janë përmbytur dy herë. Pra, meqënëse është e përsëritur nga ky komision që kemi nënshkruar për t'u ngritur, kërkojmë të dalin shkaqet, pasojat dhe mënyrën se si do të sillemi në të ardhmen në fillim të mandatit dhe ekzaktësisht në muajt korrik-gusht. Komisionet përkatëse të Këshillit të Këshillit Bashkiak janë trajnuar nga institucioni i bashkive të forta përsa i përket emergjencave civile, ndryshimeve të reja klimaterike. Në muajin gusht dhe konkretisht, ekzaktësisht në datën tridhjetë e një të tetit dy mijë

e njëzet e tre, pak ditë mbas kohës, mbasi komisionet tona kishin bërë këto seminaret. Se si do silleshin me ndryshimet, por ky problem më pas u la si shumë punë të tjera dhe kjo u mor për të kaluar radhën. Dhe nuk ndikojnë në programet buxhetore planet e ndërhyrjeve për të përmirësuar ose zbatuar për të sjellë në ndihmë që në situata të jashtëzakonshme të ishim më përgjegjës dhe më efikas. Nëpërmjet këtij komisioni, nuk duam të bëjmë as rolin e gjykatës, as rolin e hetuesisë, as të prokurorisë, po nga ana administrative, të shohim a janë të mjaftueshme fondet, a ka probleme. Në zbatimin e urdhërave dhe të kryetarit të bashkisë nga ana e administratës, a kanë aftësinë e mjaftueshme të nevojshme përgatitjet profesionale? Dhe mund të përfshihen në të ardhmen në këto problematika për të bërë një strategji Inxhinier hidro-inxhinier të tjerë të përfshihen për të marrë masa paraprake për të gjykuar mbi volumet financiare. Për të gjykuar mbi volumet financiare që do të mbështetin, a duhet të bëjë bashkia këto? Apo duhet? A i ka mundësitë apo duhet t'i drejtohemi qarkut dhe qeverisjes qëndrore? Të gjitha këto ne duhet të shohim në kuadër të ndihmës dhe mbështetjes qytetarëve të njësisë administrative Gorë. Të cilët kanë ndërtuar jetësën e tyre dhe po dëmtohen në mënyrë permanente dhe dëmtohen bizneset e tyre dhe infrastruktura në mënyrë frekuente. Pra, nuk pra, këtu nuk kemi të bëjmë me dublimin e punës së administratës, por ne jemi në rolin tone, si këshillë, i cili një nga tre rolet e tij kryesore ka dhe mbikëqyrjen e punës së të administratës. Pra, jemi në funksion kushtetues, në funksion të ligjit. Jemi këtu për me nismën e komisionit opozitar të paraqitur. Konform rregullores së Këshillit Bashkiak, por natyrisht komisioni mund ta drejtojë mazhoranca, megjithëse nga shembujt e fundit edhe të komisioneve të ngritura parlamentare mund ta drejtojë edhe opozita. Këto ishin opinionet tona përsa i përket problematikës lidhur me çështjen e ngritur. Këtë çështje dhe përmbytjen e rrugës nuk po e heton prokuroria. Prokuroria po heton kallëzimin tim të vitit 2020. Flasim nëntor dhe janar. Administratori aktual i njësisë administrative Gorë thotë që përmbytjet nga rrshjet e mëdhaja. Bashkia thotë në letër në të gjitha letrat që kjo ka ndodhur për shkaqe natyrore. Banorët kanë ngritur një version të tyre dhe janë drejtuar institucioneve. Avokatin e popullit, përpara se ta pyesim nga Maliqi, e pyesim edhe duke e pasur afër. E kemi pyetur dhe nuk ka asnjë pengesë për ngritjen e komisionit. Nëse kini një letër nga prokuroria, nëse kini një letër nga prokuroria, se çfarë po hetohet, mund t'ia bëni prezent këshillit nëse keni një shkresë nga avokati i popullit që ju thotë mos e hetoni ju, se po hetojmë ne. Ta bëni prezent. Këtë historinë me Yllsonin, pa Yllsonin, si ka ardhur, pse ka ardhur, pse ka ikur Yllsoni? Zgjidheni me faktin ndryshe. Përgjigjuni banorëve që thonë ka probleme dhe ish administratori që thotë është hapur kanali i hidrocentralit italian që po rregulloni rrugën e Mesmalit, mos bëni veprime të cilat do kostojnë problemat e prokurorisë. Prokurorisë nuk ia dalim dot. Dhe institucioneve, askush prej nesh të gjithë jemi detyruar në hetim. Mos fallsifikoni shkresat, mos i mbushni ato jashtë afatet. Kjo është problemi që keni. Ju faleminderit, faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi gjë, po kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve. Më duket se po ndërrojmë, po ngatërrojmë kompetencat e institucioneve. Këshilli i Bashkisë funksionon në bazë të ligjit të dy mijë e pesëmbëdhjetë. Neni pesëdhjetë e katër, lexoni kompetencat tuaja dhe zbatoni. Unë nuk ju kam ndërhyrë ndonjëherë, por do desha që edhe ju mos ndërhyni kompetencat e ekzekutivit. Kini

një pikë në ligj dhe ndoshta ka ardhur koha që të rishikoni edhe rregulloret e funksionimit të këshillit. Pasi më duket se keni futur në këto rregullore, çfarë keni menduar? Ligji parashikon që ju keni të drejtë të organizoni mbikëqyrur kontrollin e brendshëm të bashkisë. Këtë e jep ligji. Mund ta bëni, por nuk thuhet në asnjë vend që ju mund të ngrini komisione hetimore. E ku e di unë çfarë janë këto që s'kisha dëgjuar ndonjëherë. As ne s'ngrejmë komisione hetimore, se nuk jemi hetues, nuk jemi juristë, nuk jemi ekspertë. Ne po në momentet e caktuara, kur ju keni një shqetësim, mund të kërkojmë ekspertë, siç kemi kërkuar. Ata të gjeologjisë për studimet gjeologjike në rastin e rrëshqitjeve në Kakaç. Në rrugën e Vërçunit, në qoftë se është e domosdoshme, mund t'i sjellim edhe në rrugën e Mesmalit. Po ka rrëshqitje të tilla që kanë të bëjnë me Lëvizje tetonike të tokës themi, po jo më nga sasitë e rreshjeve të tepërta në një ditë 134 milimetra, vetëm në një ditë. Nuk e di a e keni parë ç'është bërë në Athinë, a e keni bërë ç'është bërë në Itali, që ka në rreshje më pak se ne ne. Këto janë fatkeqësi natyrore, patjetër mund të ketë brenda edhe elementë të cilët duhen diskutuar, por s'mund të jetë, s'mund ta bëjmë ne. Kështu që në këtë aspekt, unë do ju kërkoja Këshillit të Bashkisë të zbatojë kompetencat që jep ligji dhe mos ndërhyjë në kompetencë. Kërkoni informacion t'ia u servirim neve për atë çfarë ndodh. Mund të mos jeni shumë të kënaqur, mund të kini problematika të tjera që mund të ketë vepër penale në to, apo mund t'i drejtoheni prokurorisë. S'kini asnjë, mund të dyshonin dokumentacionin, afate, ku di unë. Patjetër, është e drejta juaj, jo vetëm si këshillë, jo vetëm si grup, po dhe individualisht si persona të veçantë. T'i drejtojni instancave përkatëse, të cilat merren me këtë punë. Ne jemi të gatshëm si institucion, si ekzekutiv, t'u japim çdo lloj informacioni, të cilën bëjmë jo vetëm në këtë zonë, por në të gjithë territorin e bashkisë për situatën e përmbytjeve, ne e kemi sot një pjesë të konsiderueshme të fushës të përmbytur për efekt të çarjes së lumit Devolle-Dunavec. për të cilat sapo kemi mbyllur dokumentacionin e dëmshpërblimit dhe po e çojnë për efekt kompensimi në qeveri. Sot do të çojmë gjithë dokumentacionin, është mbyllur dhe do të falenderoj gjithë grupet e punës, gjithë fermerët për bashkëpunimin dhe për mirëkuptimin. Ke punuar prej ditësh në rrugën e Mesmalit. Me mjete e private e shtetërore edhe të bashkisë, për të ta sjellë sa më në kushte normale lëvizjen në këtë rrugë. Siç kemi ende edhe një rrugë të bllokuar në zonën e Moglicës, ende edhe sot që flasim, pasi rrëshqitja është shumë më e madhe. Në pjesën e Kodrasit, për të cilën kemi kërkuar mjetet e ushtrisë, edhe për atë rrugë, edhe Mesmalit dhe për Selcën, në kuptimin që të bëjmë një çakëllim disa, pasi është një ndërhyrje goxha e. Të paktën dhe banorët duhet ta dinë, por edhe ne e dimë që ka ditë të tëra që po punohet atje pa ndërprerje për efekt të rrëshqitjeve që ndodhin në territor. Mund të ketë elementë të ndryshëm, nuk mund ta ndaj unë. Specialistët tanë, ata që kemi, na sjellin informacion mbi efektin e rreshjeve, mbi efektin e prurjeve të shumta, etjera, etjera. Kërkoni informacion prej nesh, jemi të gatshëm t'ia sjellim në çdo moment. A do të ndërhyjmë? A e kemi detyrim ne? Patjetër, patjetër, edhe rehabilitimin e rrugëve, edhe masat që duhet të marrim në vazhdimësi për efekt të kësaj. Kësaj situate, e cila ndonjëherë na na mëson edhe neve, që duhet të punojmë më mirë dhe duhet të kërkojmë më shumë llogari ndaj instancave të tjera, që se jo çdo gjë varet prej nesh, lumenjtë nuk i administron bashkia. Kolektorët kryesorë nuk i administron bashkia, po ndoshta duhet të kërkojmë edhe ne më shumë llogari në kuptimin që ato të kenë më shumë investime kapitale, më shumë pastrime në kohën e verës, që këto lumenjtë janë më të thelluara, pavarësisht se prurja është shumë e madhe në këto tre katër ditë që shkovi

sa për të gjithë vitin. Të gjithë ujërat që bien që në Devoll, që në Korçë, që në Maliq, të gjitha vijnë vetëm në një pikë, që është lumi i Devollit, ura e Maliqit. Dhe llogarisni sikur të hedhësh një kan me ujë në një vend që të ka vetëm një vrimë të vogël, kështu që duhet ta merrni në konsideratë të gjithë këta elementë. Nuk po marrë pastaj pjesën e rreshjeve në gjithë zonën malore, që nga Dushari edhe deri në Gorë, e cila të paktën është në pjesën tjetër, nuk zë pjesën e fushës. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, zoti kryetar.

Lulëzim Hoxhaj: Përshëndetje të gjithëve në lidhje me komentin e kryetarit ose argumentat që i dha kryetari për ngritjen e këtij komisioni. Unë personalisht kam një opinion tjetër. E para një herë, ngritja jo vetëm e këtij komisioni, por çdo komisioni, dhe është thjesht sepse hetimor është shkruar në rregullore dhe në rregullat që janë me fjalë, quhet ngritja e komisionit hetimor dhe fjala hetimor nuk ka të bëjë fare me ato që u thanë këtu dhe ashtu, bile bile edhe në fjalën e Yllsonit, aty u tha në shqip. Më duket që nuk ke ky komision, nuk ka për qëllim të hetojë. Të jetojë në kuptimin nuk kemi grup, nuk do ngrejmë grupe tusash për të jetuar, por thjesht për të vlerësuar këtë situatë që është problematike. Me të thënë të drejtën, edhe unë vetë, sepse unë jam një nga firmëtarët e kësaj kërkese dhe e kam bërë me një bindje dhe me ndërgjegje të plotë. E para që unë dua të them këtu, dhe e fundit bile, është kjo që për të gjithë këtë situatë, vërtetë është dhënë një informacion. Janë ngritur grupe, jo vetëm për zonën e Gorës, por për të gjithë situatën që ndodhi në Bashkinë e Maliqit, por nuk është thënë asnjë fjalë për shkaqet. Të gjitha këto kanë qenë vetëm konstatime. Cilat janë konstatimet? Është bërë ky dëm nga përmbytjet e mëdha, nga shirat e mëdha, etjera, etjera. Tani në opinionin tim, asnjëri prej nesh, asnjëri prej nesh, asnjëri nga Administrata që kemi ne në dispozicion nuk është e aftë dhe në gjendje të përcaktojë dhe thotë që shkaku i kësaj situate ose për segmente të caktuara. E dakord, natyra nuk diskutohet se po mos kishte rënë shiu, edhe breshëri të mos ishte në situatë. Ne nuk do ishim sot dhe nuk do kishim diskutuar këtu. Por asnjëri nuk është në gjëndje për të dhënë një përgjigje të saktë, edhe ky komision që do të ngrihet. Nuk është në gjendje për të thënë që e ka fajin reshja, por aman ky komision e ka për detyrë dhe mund të bashkëpunojë dhe të marrë forca që janë kompetente për të dhënë një verdikt për këtë situatë. Mund të marrë dy inxhinierë, një inxhinier hidroje me licencë, për shembull, dhe ta verifikojë dhe ta shikojë situatën. Dhe nuk ka absolutisht asnjë gjë të keqe dhe nuk bie. Unë mendoj që nuk bie ndesh as me rregulloren as me të gjitha. Është më mirë që të themi pse ka ndonjë problem tjetër. Duke mos e hetuar dhe duke mos thënë shkaqet kryesore, ne vazhdojmë akoma me situatën. Po ndodhi situata dhe hajde do bëjmë. Bashkia është të kryhet punëve dakord dhe të bëjmë dëmshpërblimin ose të bëjmë rregullimin e rrugës e tjera. Kush i paguan këto? Të gjitha këto i paguan, i paguan taksa pagusi, i paguan buxheti i bashkisë. Në rregull, kur është fatkeqësi natyrore, patjetër bashkia duhet të paguajë bashkia. Por kur është një dëm, marrim e supozojmë gjithmonë, e supozojmë këtë e nxjerr. Këtë e nxjerrë hetimi, prandaj dhe kjo fjala hetim, kjo nuk përdoret vetëm për këshillin bashkiak, po dhe të marrim edhe instanca më të larta qëndrore. Komisioni hetimor quhet, po jo se ai komision merr në heton çështje penale dhe të vijë përpara përgjegjësive të tjera. Domethënë, ky komision ngrihet vetëm për të zbardhur të vërtetën, dhe unë mendoj që nga e vërteta nuk duhet të kemi.

Nuk duhet të kemi frikë. Nuk e besoj që ka njerëz këtu që e mendojnë këtë, por të edhe mos ngritjen e këtij komisioni ose duke e gjykuar këtë paragjykuar komision, unë e mendoj që është një gabim dhe gabim i madh. Prandaj, ta mendojmë më kështu, edhe është në të mirën e të gjithëve, edhe të administratës, edhe të Këshillit, edhe të gjithëve, edhe të atyre banorëve atje, është në të mirën e të gjithëve në vitin e këtij komisioni. Të themi të vërtetën, të më thoni mua, edhe ai informacion. Unë nuk fola atë ditë. Atë ditë nuk fola, kisha shumë për të folur, por nuk fola. Nuk fola për arsye sepse nuk doja që të trazoja gjërat. Por është dita me fjalë për t'i thënë ca gjëra të vërteta. Është bërë gjithë kjo ashtu, nuk është thënë, nuk është thënë. Ore, dakord mo, dakord, përmbytjet po mirë mo, dikush ka. Kemi dhe një përgjegjësi, ose ka dhe të themi, mund të ketë edhe faktorë të tjerë për të cilat aludohet, aludohet shumë, le të le të le të hetohet, le të le të vërtetohet, le të vërtetohet e kundërta kësaj që themi ne.

Ornildi Demollari: Luli, mbarove?

Lulëzim Hoxhaj: Mbarova.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Unë i qëndroj shpjegimit që bëri kryetari i bashkisë. Po, hape mikrofonin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Këshilli me ligj bën kontroll të brendshëm, por është kontroll në kuptimin që kontrollon çfarë kemi bërë ne. S'mund të bëjë kështu, bile është e zgjidhur kjo si llogaritet cilat janë shkaqet. Ne kemi të evidentuar me institucione shtetërore që matin rënien e rreshjeve në territor, sa është për këto katër pesë ditë. Dhe të shpjegon që në katër pesë ditë ra rreshjet e tërë vitit. Sa është volumi që mban ky lum? Sa është aty lumi? Nuk lëviz. Atëherë, hajde të kërkojmë ekspertë të bëjmë një situatë hidrike dhe t'ia sjellim këshillit, se as ju as ne nuk e bëjmë dot këtë punë. Kështu që në këtë aspekt, në qoftë se duam të bëjmë shoqe, po bëjmë një komision hetimor, sikur cfarë shtë bër etj. Prandaj po them, ju kini të drejtë të ngrini në një komision të përkohshëm për situatën e përmbytjeve, për të parë si ka vepruar bashkia. Cilat janë dokumentacioni që ka bërë? Cila është kronologjia e ndjekjes? Kjo është normale. Kjo është normale, por tani që ta ndani edhe ta çoni në një drejtim tjetër këtë punë, unë do të do më dukesha. Jo normale.

Yllson Ibrahimllari: Sqaruam se çfarë drejtimi kishim, me gjithë respektin maksimal për kryetarin e bashkisë.

Ornildi Demollari: Ju lutem, po mirë se e bëre shpjegimin tënd.

Yllson Ibrahimllari: Atëhrë të lutem, mund të ngresh kartonin, mund ta hedhë këtë votim dhe bëheni si doni, por një gjë mos harroni, ju lutem keni gënjyer. Të gjithë institucionet? Ti duhet t'i kthesh përgjigje avokatit të popullit për çfarë të ka kërkuar ti si këshillë bashkiak. Më vjen keq tani, dhe lërini ato urdhërat vertikale që paria nuk e do këtë komision të ngrihet. Po flasim për një

komision hetimi administrativ që na jep ligji. Dhe rregullorja, doni ta shkelni? Shkeleni, hidhen votim.

Ornildi Demollari: Ishte i mjaftueshëm shpjegimi që bëri kryetari. Pse duhet të?

Yllson Ibrahimllari: Sepse ti në ndihmë të kryhet, megjithatë faleminderit, ti duhet të vazhdosh dhe mos i shkosh të njëjtës bisedë. Edhe shpjegimin po ta shpjegojmë në kuptimin funksional politikisht je i paaftë. Në kuptimin njerëzor ke mangësi të mëdha në raportet individuale, je mosmirënjohës.

Ornildi Demollari:Të njëjtën gjë nuk e mendoj unë për ty, po edhe po ta mendoj, s'kam ndërmend ta them. Faleminderit, po emrin s'ta përmëndi askush, kështu që po të morën fjalën.

Almir Elezi: Kryetar, mund të them diçka?E përmendmi Hidrovorin disa herë. Në qoftë se do kishte funksionuar, ne si grup opozitar shkuam në terren në momentin që binin rreshjet. Edhe e pamë që hidrovori nuk funksiononte. Tani, në qoftë se do kishte funksionuar, nuk do t'i kishe shpëtuar dhjetë hektarë tokë, apo njëzetë, apo tridhjetë, apo njëqind. Edhe kush mban përgjegjësi këtu? Që ai nuk funksionoi, kjo është ajo që po kërkojmë ne.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po, unë jam munduar ta shpjegoj disa herë këtë moment, por nuk do të kuptosh ndoshta. Ne kemi realizuar një investim në hidrovori i Vreshtasit. Me fondet e emergjencave civile. Dhe çdo gjë është transparente. Hodhe disa instituata për vlera që nuk e di ku i kishe dëgjuar nëpër media dhe për të tjera, por që s'janë të vërteta. Dakord, dakord, dakord. Nuk të, nuk të akuzova, por nuk janë të vërteta. Por po të shpjegoj që uji nuk ka shkuar tek hidrovorja e para, por nga ana tjetër, në qoftë se rreshjet do të vazhdojnë me të njëjtin intensitet. Ne ka mundësi të hapim rezervuarin e Podgories, që të mbytim edhe ca toka të tjera. Pasi sot që flasim, po shkon drejt pikës kritike, drejt shkarkuesit katastrofik, siç njihet në. Se edhe ne kemi mësuar këto gjëra për të shkarkuar, pasi është mbushur mbi limitet vjetore. Ti thuaj hidhje ca ujë nga fusha.Ai investim i hidrovorit, që të kuptojmë, ka nevojë edhe për një investim tjetër për kanalin që çon ujin nga hidrovori i vreshtasit në drejtim të rezervuarit ujëmbledhësit të Podgories, që të jetë i betonuar, mos ketë rrezik për familjet në zonën e Nizhavecit. Pasi edhe ai pëson rrëshqitje, mbushje e të tjera, dhe ne kemi aplikuar përsëri edhe këtë vit për një investim të dytë, që ne ta kemi gatishmëri, jo për atë çfarë ju mendoni se ajo është. Është bërë që në kohën kur kanë qenë në bëtë, që të mos mbytësh Vreshtasi njësitë, shpitë, edhe për të hequr aq sa heqe. Por në këto kushte që jemi, kjo nuk është e mundur.

Almir Elezi: Kryetar. Hidrovorin, ai burrë që e ka bërë atë, ka qenë shumë i zgjuar. Rezervuari i Podgoricës në momentin që mbushet, derdhet në rezervuari i Grabovicës. Ai i Grabovicës në Liqenin e Pogradecit dhe nuk derdhet njëherë në fushët. Mos i ngatërro gjërat. ka një mënyrë funksionimi të përsosur.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Atëherë po të shpjegoj, ka dy momente, një në varësi të prurjeve, ai shkarkues katastrofik që është në atë zonë, nuk e mbulon prurjen që vjen nga mali dhe nga ajo liqeni. Që mund të krijohet nga këneta dhe pastaj do të mbytim dy zona të caktuara. Ajo po shkon drejt pikës kritike, por treqind litra që ka kapacitetin, ajo nuk ndryshon asgjë në përmbytjen e fushës. Po tani, se unë po ta them kaq, e ka ti thua, nuk e ka.

Ornildi Demollari: Po, faleminderit.

Faslli Zholi: Po tashti duhet të sqaroj një diçka në lidhje me këtë kërkesë. Ne, fatkeqësisht, ky vit që kaluam na rrezikoi qytetarët e parë dhe institucionet përkatëse. Nuk diskutohet që a pati përmbytje të mëdha, nuk diskutohet. A pati dëme, nuk diskutohet, po shkaqet se të kujt ishin. Kjo ka një çik përgjithësi edhe dikasteret përkatëse, sepse mua në këtë kërkesë m'u kërkua që ta futnim që në rendin e ditës dhe nuk kam firmosur në këtë. Arsyeja e vetme, sepse desha që të njihesha më mirë, siç po njihemi sot, për ta ngritur këtë komision. Dhe ky komision kërkon që dhe mua cila më shqetëson, sepse ka ardhur një shkresë edhe unë e kam parë me firmën e shumë qytetarëve që kërkojnë një zgjidhje. Do të thuash që është marrë masa të është punuara, kërkojnë shkaqet përse. Unë di këtu që nuk e kam idenë, kam qenë edhe atje në atë vend, se këtu nuk duhet klauzuar. Individi Yllsoni apo iksin, sepse Yllsoni edhe Yllsoni para se ka ardhur këtu është qytetar, kushdo dhe secili nga ne është qytetar. E po të ketë nevojat e tij, është e patjetër e padiskutueshme të zgjidhet problemi. Po ça me ashtu dua të të them, aty ka firma private që operojnë në atë sektor. Dhe ato firma, në qoftë se është siç kemi dëgjuar. Për fajin e tyre, pse jo, le t'i dalin për zot. Dhe nuk ka pse ta paguajnë taksa paguasit shqiptarë këtë, këtë dem që ka bërë. Sikundër po flas edhe për në Dushar, për shembull, në zonën e Moglicës. Rruga që është atje di se është bërë një kontratë Kryetar këtë nuk e di, po ma ka thënë dikush që ka qenë atje. Që është bërë një kontratë që firma kur të mirëmbajë rrugën, tani pse të mos e mirëmbajë rrugën kur ujë hidrocentralin e shfrytëzon e bën ta mirëmbajë rrugën për aq sa është bërë në kontratën me bashkinë, mos gabohet. Dhe po të ngrejmë këtë komision, siç po mendoj në opozita, unë jam pro. Sepse me të vërtetën, me të ballafaqohemi, nuk ka asgjë. Ne nuk kemi hetuesa. Po unë jam gjithmonë në krahun e atyre qytetarëve, këta që janë një pjesë, po i shikoj këtu, dhe ata që na dëgjojnë, apo ata që nuk kanë patë mundësi të vijnë. Sepse na ndodhi edhe në datën dymbëdhjetë që bëmë për. Përmbytjet kërkuam së bashku këtu, vendosëm që të ishim në këtë mbledhje dhe ta bënim një mbledhje speciale. Nuk do të varnim asnjëri, nuk kishim as lekë aty jepnim atë ditë, po t'i dëgjonim. Në anën e juaj, e mazhorancës, nuk ua erdhën. Një gjë e vendosëm bashkërisht, nuk erdhën. Po se na fikën edhe dritat, unë jam i drejtpërdrejtë me këdo dhe nuk dua të bëj.

Ornildi Demollari: Nuk e kemi objekt.

Faslli Zholi:: Se kemi objekt, po na këto rrjedhin deri këtu. Prandaj kemi kaluar që. Na na dëmtojnë dhe na prishin punën, se kemi objekt. Si ishte objekt, po ishte shumë objekt për mua.

Ornildi Demollari: Fokusohu tek ajo, tek pika që kemi.

Faslli Zholi::Fokusimi im është që. Në këtë kërkesë, të lutem, shikoheni që të dalë përgjegjësia, kush e ka atje, për shembull, e ka firma, ta mbajë firma. Këta kishe o.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një moment se dua të marr një moment edhe për takimin apo për mbledhjen e mëparshme që unë s'kam qenë në mbledhje. Është për të ardhur keq në fakt që bëhen disa takime në kuptimin jo transparent. Ju kishit kërkuar një informacion mbi situatën e përmbytjeve. Dhe nuk kish marrë asnjë njoftim, unë të paktën s'din asgjë. Mund ta ketë bërë këshilli vetë, njoftim kryepleqsh, njoftim komuniteti, etjera, etjera. Dhe pastaj vemi del atje sa themi, iu fikëm dritat. Mirëpo, këtu jemi dhe të gjithë ju mund të kuptoni që ra në masë rrjeti i brendshëm elektrik. Po, pse duhet t'i fiknim dritat? Edhe ju mund të pyesni, mund ta verifikoni. Se jemi njerëz në fund të fundit dhe në qoftë se s'ka qenë e vërteta kështu që atë ditë është djegur sahati i institucionit, atëherë kjo është pastaj sikur bëjmë lojëra me njëri-tjetrin, se duhet të jemi që ta shikojmë njëri-tjetrin në sy. Dhe kjo që po ju them unë është e vërteta, mund ta verifikoni me institucionet si ka qenë e vërteta. Megjithatë, ja që ta mbyll, të lutem. Ai moment se mund të isha unë prezent, që unë merresha, unë merresha personalisht me përmbytje. Të isha në, bile ia kam thënë kryetarit të këshillit. Në qoftë se duhet, unë vij për t'iu shpjeguar njerëzve çfarë po bëjmë ne. Por një gjë është e, cituar dhe në qoftë se ju do të bëni një verifikim, duhen ekspertë. Po doni të merrni ekspertë, siç kërkuam ne nga qendra. Mbas shërbimit gjeologjik shqiptar, për të parë cila është situata. Ja ku është Luli, ja ku i njihni ju të tërë jini me shkollë. Kërkoni ekspertë të fushës së të për të përcaktuar ore, sa janë rreshjet e rena në këto katër ditë, sipas asaj që mat rreshjet, jo nga ne. Janë iks, sa është volumi që mban ky lumë? E njëjta gjë mund të pasojë verifikimin në zonën për të cilën flasim në Mesmal, në Dushar e të tjera, cila është situata, sa është sasi e rreshjeve, se cilat janë faktorët, po duhen ekspertë. Unë si institucion nuk e marr dot në qoftë se ju thoni po, duhet të marrim ekspert që ta bëjmë. Hajde t'i marrim, hajde t'i marrim, t'i kërkojmë. Të kërkojmë nga të gjitha instancat që merren me këtë punë, po s'mund të bëjmë show kot. Kështu unë e mendoj, hajt ta bëjmë dhe të dalë e vërteta, s'kam. Dëgjo, më fal, flasim mirë me ju.

Petrit Kupe: Unë e vlerësoj shqetësimin që ka komuniteti kuptohet nëpërmjet opozitës. Por ngritja e këtij komisioni më duket sikur një kërkesë që diçka fshihet, ndoshta në punën e bashkisë. Diçka fshihej, domethënë sikur duket sikur bashkia fsheh shkakun. Bashkia e ka konstatuar. Por shkakun e kanë nxjerrë rreshjet në qoftë se ju mendoni se ka dhe shkaqe të tjera. Nuk është kompetencë bashkia ta gjejë këtë shkak, mendoj unë. Po aq më tepër dhe ne si këshilltar, ia do vete unë si këshilltar. Atëherë jam dakord. Të gjendesh shkakun, shkakun e përcaktojnë specialistë, bashkëngjitin rreshjet me faktorë të tjerë të pjerrësisë së pengesave të tjera. Unë jam dakord të vete e shpreh gatishmërinë, por shkakun e vërtetë nuk jam unë që të përcaktoj. Këtë kisha, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:: Unë do bëja një propozim, se nuk do dalim dot kështu. Ka një propozim, ka një propozim, hidhet propozim në votë. Të kërkohet o një plotësi, moj një gjë edhe kaq. Ju lutem, e kalojmë votim pikën dymbëdhjetë.

Faslli Zholi: Një diçka vetëm për këtë, të dritave të unë nuk e di, qoftë ajo që thashë. Dhe e lamë bashkë që do vinin disa herë këtu, me këshilltarë, me kryepleq, me thamë që të bëjmë një mbledhje, siç i takonte.

Ornildi Demollari: Tani mos u kthe atje, o Fasllo të lutem, jo më u ktheva se për ta qartësuar këtë histori që ram dakord kështu dhe u veprua ndryshe.Ju lutem, jo mos vazhdo me të, se s'e kemi në re në ditë të parë. Të lutem, e kalojmë në votim. Kush është dakord?

Lulëzim Hoxhaj: Jo, jo, të lutem. Jo, vetëm një fjalë, më të lutem. Një minutë, më një fjalë. Po, një fjalë, o burrë, dakord, mirë. Petriti sapo tha një të vërtetë. Shkaku nuk është thënë, edhe nuk e themi dot ne. Pikërisht për këtë të vërtetë që tha Petriti për këtë ditë, për këtë kërkohet ngritja.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po jo, moj shkaku është thënë, o Luli. Jo, nuk është thënë. Aq litra në katër ditë sa bie në Korçë për tërë vitin, e kanë thënë institucionet. Të lutem, të lutem, të lejoj. Kaq është them, jo kaq është them. Po pra, kaq rreshje sa ka rënë në katër ditë, bie në një vit. Atëherë, thoni një vit, bjer në katër ditë, i merr ky numër, po dhuk diskutohet. Kaq di të them unë, pastaj të tjerat nuk i shtoj dot.

Lulëzim Hoxhaj: Po më fal një minutë. Nuk po hyn në detaje, tani nuk po hyn detaje. Po të hyn detaje, do bini dakord me mua, po nuk po hyn detaje. Tani po them, kur themi për shkaqet. Për shembull, ta zëmë ato informacionin që zëmë këtu përpara në mbledhjen e parë ka qenë konstatim. Kanë rënë kaq milimetra, si dakord më po mos kishin rënë aq milimetra. Nuk do ishte kjo situatë. Por është ajo që thotë pak a shumë, që thotë edhe kolegu këtu. Në rast se do kishte një situatë, nuk do ishte flas për rastin konkret. Unë kam qenë një nga ata që kam thënë këtu, që nuk e them që ajo që kam thënë unë është e vërteta. Por aman, mendoj, kjo është një mendim, le ta vërtetojmë këtë, që edhe firmat private që punojnë në atë zonë atje, e kanë favorizuar këtë situatë. E kanë favorizuar duke i hapur ato diga në një moment jo të përshtatshëm. Kaq e kanë shtyrë. E kanë mobilizuar atë lumin atje, i ka dhënë një dorë dhe ka bërë atë që ka bërë, që nuk e ka bërë ai për njëqind vjet, për pesëdhjetë vjet. Që kur është bërë ajo rrugë, se kanë ndodhur edhe herë tjera. Tani kam një gjë, unë se nuk e ashtu dot. Edhe me atë që tha Vera në fillim, edhe me këtë që po trajtohet këtu, këtu nuk bëhet fjalë që ky komision. Fjalën hetimor nuk e shpikëm ne, nuk e kemi ne. Po e ka rregullarja, po po, po, ky është thelbi. Po për këtë, do ta hedhësh udhëtim. Nuk është fjala hetimore, ne nuk hetojmë, por aman, ky komision ka të drejtën e vet të të. Abonoj të marrë të thërresë një specialist, dy specialistë, ndoshta nga më të mirët e vendit, dhe të jap një përgjigje kësaj situate.

Ornildi Demollari: Mirë faleminderit, e kupton, e morë fjalën për herë të dytë për këtë e the.

Pranvera Begolli: Kryetar, të them gjithçka të lutem. Më falni, tani kot të lutem, do të kalojmë në votim.

Neresida Shindo: Jo, nuk do të kalojmë në votim, sepse nuk kalojmë me nxitim. Vera,

Pranvera Begolli: Të lutemi nnë sekondën. E dyta, ky i komisionit Hetimor. Ju zgjidh gjë problemet fermerëve, jo. Ja u ka zgjidhur bashkia, ministri i bujqësisë, shteti. Nuk e zgjidh komisionin.

Yllson Ibrahimllari: Zgjith shkaqet, ja se banorët, pyetin ç'i banorët këtu mbrapa. Çfarë mendojnë ata nga se ka ardhur?

Pranvera Begolli: Hidhe në votim, kryetar.

Ornildi Demollari:Të lutem, e kalojmë votim.

Yllson Ibrahimllari:Dëgjoj banorët që të kanë ardhur në sy.

Ornildi Demollari: Kush ishte dakord me pikën dymbëdhjetë?

Neresida Shindo: Duhet t'i respektojmë dhe banorët para se të votojmë.

Ornildi Demollari:Nëntë janë dakord, kush është kundër?

Neresida Shindo: Duhet të respektojmë banorët, të lutem.

Ornildi Demollari Njëmbëdhjetë veta kundër, nuk miratohet faleminderit.Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës, që është projektvendim për fillimin e procedurave për zgjedhjet në fshatrat e mbetura pa zhvilluar zgjedhjet për kryetar fshati dhe në fshatin Rov ku është krijuar vakancë. Iu lutem, komisioni.

Pranvera Begolli: Komisioni u mblodh dhe pa të arsyeshme që edhe ky projektvendim të vijë në mbledhjen e këshillit të mos hiqet nga rendi i ditës. Por natyrisht, të të thotë. Administrata të na japin shqyrtime përkatëse, sepse.Aktualisht, po ankohem për një rregullore që nuk është perfekte dhe detyrimisht ju mbetet si detyrë ju dhe kryetari, ju si kryetar dhe sekretari, të bëni ndryshimet në rregullore. Përveç asaj, unë di që është edhe në proces gjyqësor dhe derisa jemi në procedura gjyqësore dhe derisa duhet të rregullojmë rregulloren, ta lëmë për një afat tjetër zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave.

Ornildi Demollari: Ju si komision mendoni që të shtyj.

Yllson Ibrahimllari: Unë jam si komision, se ishim komision. Ajo zonja po flet për vete. Të lutem, tani dy sekonda. Të lutem, me respekt maksimal. Kemi një vendim , po për pikën trembëdhjetë pra jam nënkryetar i komisionit. Në respekt të zgjidhjes që i ka dhënë kryetari i problemit Zvezdës, kryetari ne kemi bërë. Jemi konstituar në nëntëmbëdhjetë i gjashti dy mijë e njëzetë e tre. Më vonë, mbas pesë gjashtë muajsh, kryetari ka bërë një emërim të kryetarit të fshatit në Zvezdë. Është kaluar në komisionin që qe në atë kohë dhe ka dalë tre me dy për tu ri. ribërë zgjedhjet në Zvezdë, kryetari mund ta mbajë kryetarin e këshillit të fshatit Zvezdë gjatë gjithë kohës, derisa këshilli të veprojë. Në moment jemi me një emërim në Zvezdë. Kemi problemet, kemi një vendim të Këshillit Bashkiak, i cili është shprehur për zhvillimin e zgjedhjeve në drithas poshtë ka pasur një problem me kandidaturat nga subjektet politike. Kemi një vakancë për efekt të fatkeqësive natyrore që i shprehen ngushëllime familjes në fshatin Rov. Kemi dhe një problematikë tjetër që duhet ta shikojmë juristët, sepse meqë ne i zgjidh kërkam të gjitha gjërat, gjykata administrative e apelit ka çuar në shkallën e parë problematikën e zgjedhjeve në bashki për kryetarët e fshatrave në bashkinë, ajo do të shprehet kur të vijë koha. Ne nuk kemi pengesë ligjore për këtë, kemi një problematikë tjetër ligjore. Që kryetarin e një fshati, po të doni, s'dua të cilësoj e keni me vendim të shkallës së parë për vjedhje të ndihmave ekonomike, do ta hapim vakancën. Ne nuk kemi mundësi, duhet të hamendojmë rregulloren për sa i përket arsimimit. Sepse popullsia është. Ndoshta edhe për sa ndonjë nen tjetër, i cili na vështirëson gjërat, dhe ne duhet të hapim procedurën në zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave që do zgjidhen në bazë. Kryesia do zgjedhi kryetarin. Nuk kemi rënë dakord ne që ta shtyjmë, se ka një proces ligjor. Ne kemi rënë dakord që ka rënë këshilli bashkiak. Ka rënë dakord që do bëhem ke vendim. Është i juaj. I neve të gjithëve, po i firmosur nga ju, që zgjedhjet në fshatin Drithas poshtë do bëhen. Kemi rënë dakord te komisioni i ligjeve dhe i mandateve, që Zvezda do ketë një kryetar. Ne e lajmërojmë subjektet politike, paraqesin kandidaturën, hapin procedurën, e lejojmë edhe dy muaj më mbrapa nga tani. Nuk është asnjë problem, s'kemi ndonjë nxitim ne, sa i lamë kaq kohë. Në Rov do të zëvendësojë se ka nderuar jetë. Në fshatin tjetër, si ta mendojë juristi, doni të mbajmë një kryeplak, i cili vjedh ndihmat ekonomike. E mbajmë faleminderit, faleminderit, kryetar keqja.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Duhet të shpjegojë vetëm, jo me unë mendoj, por është e drejta juaj që ju urgjentisht duhet të shikoni. Të shikoni rregulloren e funksionimit të këshillit të bashkisë, por dhe të zgjedhjes së kryetarëve të fshatit. Ndoshta edhe ajo që tha doktori, që nga arsimi, që nga problematikat tjera, që nga mënyra e votimit etj., ka një draft rregullore për këtë punë. Ka dhe shumë që në një farë mënyre, nga ajo që shikoj unë, e gjithë procedura nuk ka shkuar mbi kuadrin ligjor apo nënligjor të themit rregullor. Por ajo çfarë unë marr nga kjo piketë është. Së dyti, pas kësaj, mendoj që në Zvezdë, edhe pse janë bërë zgjedhjet për kryeplak. Dhe kam dalë dhe kam firmosur, edhe kam firmosur. Nuk e di pse e ka rrëzuar këshilli. Unë kam një material këtu për zgjedhjet në Zvezdë, të firmosur nga anëtarët e këshillit dhe pa asnjë problem, të firmosur edhe nga banorët.

Yllson Ibrahimllari:Të lutem, me respektin maksimal, e kemi mbyllur këtë temë.

Dakord, dakord. Jemi shprehur që në Zvezdë dhe do vemi. Jam shumë dakord. Biles do shkoj unë, do bëj fushatë për atë që ke të dashur ti dhe shumë të mrekullueshëm.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Dakord, dakord dhe Fevriu, Daniela, Rovena, edhe Andonaqi Risto firmosin që çdo gjë ka shkuar në rregull. Në momentin që këshilli nuk e gjeti, unë e emërova se ligji ma jep këtë mundësi që të. Për fshatin Drithas poshtë, nuk është fshat. Dhe prefekti, të lutem Luli, e di që e ke me merak këtu. Po, jo, jo, jo, të të shpjegoj, të shpjegoj. Institucioni i Prefektit shprehet që nuk është fshat më vete. Ju mund të vendosni një administrator, por s'mund të vendosni kryetar fshati, sepse me ndarjen territoriale ai nuk figuron fshat.

Yllson Ibrahimllari: Quhet me rregullore ndërlidhësi komunitar. Ia kemi detyrim komunitetit të ketë një përfaqësim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nocionet e rregullores së.

Yllson Ibrahimllari: Patjetër, më nuk po diskutoj që i di më mirë nga unë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Jo, jo, patjetër që i di më mirë.

Yllson Ibrahimllari: Po, patjetër, por unë po diskutoj këtë gjë. Që këtu kur flasim, të jemi korrekt, ne nuk po pengojmë punën tuaj. Atëherë në Zvezdë do bëhen zgjedhjet. Në Drithas do bëhen zgjedhjet, në Rov do bëhen zgjedhjet, tek ai fshati tjetër që s'po përmendim për efekt etik.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në momentin që ka një vendim gjykatë të formës së prerë dhe ne na vjen, jemi detyruar ta zbatojmë . Unë nuk kam sot dhe s'dua të aludoj për asnjërin, por që ta mbyll për rastin e Rovit ishte një rast, unë aty kam emëruar dikë siç kam bërë për Zvezdën. Në momentin që këshilli mendon të zhvillojë procedurat, patjetër hyn të drejtë. Është e drejta juaj, kompetenca juaj e këshillit të bashkisë. Por unë mendoj që të e keni urgjente riformatimin e funksionimit rregullor të Këshillit të Bashkisë. Në qoftë se kërkonin ndihmën edhe tonë apo të këshillave bashkiak të bashkive të tjera, do ishim të gatshëm të ishim pjesë e kësaj pune.

Neresida Shindo:Më fal kryetar, e dinë fshatarët që ju keni emëruar një në Rov, një person. Po, po, fshati thotë jemi pa kryetar, prandaj. Me aq sa dimë, jam pa, duhet të ishin njoftuar që është dikush i komanduar, sepse ata nuk kanë se ku të ankojnë për një ankesë të tyre, me aq informacion sa kemi, dhe ne duhet të ishim informuar në fakt. Tani, jo se më takon kushedi se çfarë, por më thashë që të kemi një, edhe ne.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë zbatoj, unë zbatoj ligjin, dhe kur ligji ma jep këtë të drejtë.Ligji thotë që në momentin kur krijohet një vakant, derisa këshilli të zgjedhë zëvendësin, kryetari i bashkisë vendos një kryetar fshati. Këtë punë kam bërë. Nuk thotë pastaj që po bëri këtë punë, do të njoftojë tërë banorët, do të njoftojë këshillë. Nuk thotë, por në zbatim të

kompetencave që ka, ka vendosur njeri që është. Detyrë dhe detyrim edhe e administratorit të njësisë të takojë banorët, i thotë deri në zgjedhje. Kjo do të bëjë këtë punë derisa të zgjidhet kjo problematikë.

Pranvera Begolli: Aktualisht, ne e lamë në komision që përzgjedhjet e kryepleqve me sistemimin e rregullores të bëhen në një afat tjetër.

Ornildi Demollari: Po, po, e kuptova. Tek kalojmë votim, atëherë ju lutem, kush është dakord? Që të zhvillohen zgjedhjet apo të mos zhvillohen të shtyhet?

Pranvera Begolli: Zgjedhjet të shtyhen, kështu e kemi lënë.

Yllson Ibrahimllari: Zgjedhjet do të zhvillohen, po themi, nga tani në Mars.

Ornildi Demollari: Jo, jo.Miratohet sot apo të mos miratohet më saktë?

Yllson Ibrahimllari: Sigurisht që do miratohet, dakord? Urdhëro, ne jemi të miratohet sot.

Ornildi Demollari: Ja votat, një, dy, shtatë, tetë, nëntë. Kush është kundër? Numëroj, bravo, dy, pesë. Tetë, dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë kundër nuk miratohet. Faleminderit, bro, nuk miratohet materiali. Nuk miratohet materiali, të lutem, faleminderit. Atëherë kalojmë tek dy pikat, Janë edhe dy projektmendime të tjera, të lutem mos të largohesh. Ulu, të lutem, ulu. Kemi edhe dy projektvendimet që erdhën së fundmi. I pari është projektvendimi mbi mbështetjen e aktivitetit për personat me aftësi të kufizuara. Ëh, jo të lutem një nga një, një nga një, dhe të lutem mos, mos komento. E kalojmë votim këtë, ka nevojë për shpjegim kjo. E kalojmë votim? Kush është dakord? 23 vota pro.
Kundër?Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. miratohet me njëzet e një vota pro. Kalojmë tek projektvendimi tjetër për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq me Këshillin e Qarkut Korçë për moshën e tretë. Ka ndonjë pyetje? E kalojmë votim?
Kush është dakord? 23 vota pro.
Kundër?Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Yllson Ibrahimllari:Në mbledhjen tjetër, po desha të investimin e kombinatit për për Lucën, edhe për Arditin.

Ornildi Demollari: Me njëzet e tre vota pro, të lutem mos fol mbi mua. Me njëzet e tre vota pro, të lutem mos fol mbi mua. Me njëzet e një vota pro, miratohet. Faleminderit. Tani, zotëri, ke fjalën.

Qytetari: Unë jam Mestan Myfatrago, përfaqësuesi i banorëve të fshatit Selcë, Velçan, Mesmal. Lindur në Selcë dhe banues në Tiranë, në radhë të parë ju uroj suksese në punën tuaj fisnike që keni në shërbim të komunitetit. Duhet t'ju bëj me dije që unë, si përfaqësues i komunitetit të këtyre fshatrave jam në dijeni të përgjigjeve që më ka kthyer bashkia prefekti. Dhe në bazë të përgjigjeve që janë kthyer, nuk shoh asnjë rezultat që i shërben asaj që ne e kërkojmë tani. Shkak për zgjimin e banorëve dhe ish-banorëve. Sepse ju thoni që aty ka pak banorë, po aty ka shumë banorë që duan të kthehen, por kushtet nuk i lejojnë. U bë përmbytja e rrugës Selcë Velçan Mesmal gjatë të shirave të datës nëntëmbëdhjetë njëzet e tre nëntor dy mijë e njëzet e pesë. Të gjithë banorët e dinë shumë mire, që kjo rrugë për që kur është ndërtuar nga viti tetëdhjetë e pesë deri në nëntor të dy mijë e njëzet e pesës, nuk është përmbytur ndonjëherë. Shkaqet e përmbytjes janë verifikuar nga komisionet që ju keni dërguar. Nga dëshmitë e banorëve që jetojnë aty, dëshmitë e banorëve janë të tjera. Kështu që, nga ndërtimi i saj deri më sot, në këto rrugë nuk është hedhur asnjë kamion me çakull. Tashmë, ajo është bërë e pakalueshme për banorët e atjeshëm . Por dhe të tjerët që duan të vizitojnë vendlindjen dhe varret e të parëve, durimi i banorëve ka sosur dhe kërkoi me insistim që rruga të futet në prioritet dhe bashkisë. Dhe me qetësinë tuaj që ju karakterizon dhe arsimimin që keni, që të përfaqësoni komunitetin tonë. Sepse komuniteti është taksa pagusë, si të gjithë të tjerët. Durimi i banorëve ka sosur, thashë, dhe kërkoj me insistim që rruga të futen në prioritetet tuaja. Aty jetojnë njerëz që paguajnë rregull taksat. Aty buron ujë për centralet. Që janë fabrika parash, ne nuk jemi kundër investimeve dhe këto mirëbenj që investojnë, por këta duhet të zbatojnë ligjet e shtetit. Të mos na cënojnë as pronën, as rrugën dhe asgjë që ka të bëjë me ne. Aty është Lenia dhe liqenet e saj, me bukuritë e saj përrallore në Selc, Velçan e Mesmal. Kanë jetuar breza të tërë. Bë çfarë e kërkojnë ata? Ujë dhe drita i kanë ujin. Falë Zotit, e kemi edhe dritat. Por ne kërkojmë rrugë dinjitoze për të kryer nevojat tona të përditshme. Rrugë dhe vetëm rrugë kërkojmë. Nuk janë banorët e këtyre fshatrave të varur nga asistenca sociale, por ata janë të lidhur fortë pas tokës, blegtorisë dhe bimëve mjekësore. Rruga është i vetmi hall që kemi ne, të tjerat i zgjidhim vetë. Tani neve kemi të drejtën që problemin ta shtrojmë qartë dhe saktë. Dhe nëse ne bëjmë këtë, kemi bërë gjysmën e punës. Topi mbetet në dorën tuaj, pra ne të kërkojmë shkaqet dhe sistemimin e rrugës. Që ajo të bëhet e kalueshme, si në të gjithë vendin, ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, po kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ne kemi, ne kemi ditë që punojmë në rrugën e mesmalit, po siç tha në Mestani, ai jetoka në Tiranë. Edhe ndoshta do më vinte mirë të fliste ndonjë nga banorët që jeton atje. Kemi gati një javë e më shumë se një javë që po merremi me rrugën e mesmalit për atë rrëshqitje që ka ndodhur. Për ta kthyer atë në gjendje sa më të pranueshme. Kjo rrugë është futur në prioritetet tona të rrugëve të bardha me investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si edhe rrugë të tjera. Të shpresojmë që të marrë një dritë jeshile nga ana tjetër. Patjetër, ne do bëjmë përpjekjet tona për ta kthyer në gjendje sa më të pranueshme. Po mundohemi në këtë periudhë, sepse periudha është e vështirë me rreshje, me rrëshqitje. Dhe patjetër kërkon një angazhim tonë më të madh në periudhën e verës, në periudhën kur thahet. Është një rrugë e gjatë, një rrugë e vështirë për të qenë i sinqertë dhe kërkon patjetër investime

dhe fonde të mëdha buxhetore. E kam dëgjuar shpesh që thonë në lidhje me të ardhurat që krijojnë nga hidrocentralet. Nuk është se është një e ardhur e madhe, një pikë shtatë milionë lekë. Në vit paguhen hidrocentralet sipas kontratave koncesionare që ka lidhur qeveria qëndrore prej njëzet e pesë vjetësh, ndoshta, nuk i kemi dhënë ne ato hidrocentrale. A kanë bërë mirë, a s'kanë bërë mirë, nuk mund ta vlerësojmë neve. Është parë e arsyeshme nga këshilli i ministrave kur është dhënë në atë periudhë. A kanë dëmtuar ata? A kanë sjellë ata dëmtime? Unë e thashë pak më parë se e kisha pak më parë këtë si ide. Mund të jenë dhe ata një pjesë, por duhet të marrim ekspertë. Që ta vlerësojnë, ta shprehin, e i respektojnë mendimet e banorëve. Ata janë atje më afër dhe në çdo situatë e njohin situatën. Sa del lumi, kur del lumi, kur ka dalë, sa është prurja, etjera, etjera. Por po ju them që ne jemi të detyruar që kur mbushet një digë, ujin do ta lëshojmë, pavarësisht ku vete. Po ju jap një moment të rezervuar i Leminotit. E kemi lëshuar edhe lëshuesin katastrofik, edhe lëshuesin e vaditjes poshtë për të mos rrezikuar jetën e banorëve që jetonin poshtë fshatit. E kemi detyrim ligjor, jo vetëm për të, por i ndjekim në mënyrë permanente njëzet e katër orë të gjithë mbledhësat tanë, që t'i hapim dhe t'i komandojmë për ne. Patjetër, patjetër që flas sinqerisht, jo një herë flas gjithmonë, por flas gjithmonë siç e mendoj. Pastaj, si e mendoni ju, kam të drejtë apo jo, është e gjerë se secili mendon, ka mendimin e tij.

Yllson Ibrahimllari: Në këtë aspekt, një pyetje do të ndërpresë pak.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po, patjetër.

Yllson Ibrahimllari: Këto dy kompanitë që kanë dëmtuar rrugën kanë siguracion me palët e treta. Që marrin dyqind mijë euro në një fatkeqësi natyrore dhe pse këta njerëzit duhet të paguajnë me taksat e tyre dëmet e shkaktuar nga dikush tjetër. Drejtoju sigalit si këshillë bashkiak, merru lekët, hidhi në arkën e bashkisë, ndërto rrugën tani. Një llaf gojë është ajo, po çoja, çoja me shkresë, pse mund t'ia bëni, se më mundem me karton, çoja me shkresë, mund t'ia bëni si kërkesë. Jo, jo, jo, bëja ti se je ti më i miri nga neve. Bëja ti si kryetar i bashkisë, po e pjesën ligjore.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Bëja ti si kryetar i bashkisë, të lutem o doktor.

Yllson Ibrahimllari: Shumë publikisht po të them dhe të kam marrë në telefon që ditën e dytë dhe tash shko verifikoje vetë gjendjen. Nuk dalin gurët sa gjysma e sallës pa energji të fortë. E dyta, çfarë kontrolli keni ju si bord kullimi apo gjë mbi pritat, se ata mund të vdesin njerëz aty në rrugë kur dalin i hapin? E treta, dhe shumë publikisht, nuk kisha ndërmend në marrëdhëniet shumë miqësore bashkë të bëja asnjë tentativë. Tani kam një pyetje që t'ju kërkoj gjithë qytetarëve. Ke ndonjë kallëzim në Spak ti Gëzim?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Tani unë, po ose jo, thuaj, nuk kam asnjë kallëzim.

Yllson Ibrahimllari: Okej, në rregull, dakord, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po ju shpjegoj që unë jam i hapur me të gjithë këshilltarët, me të gjithë komunitetin dhe dua të sqaroj që situata e rreshjeve në të. Në zonën tonë të bashkisë tonë, por dhe në mes mal, mund të ketë efekte të ndryshme për efekt të sasisë së rreshjeve që kanë rënë. Mund të ketë edhe efekte të tjera, të cilat unë nuk mund t'i përcaktoj dot, sepse s'jam ekspert i kësaj fushë. Megjithatë, në qoftë se ne duhet të marrim ekspertë të thelluar për këtë qëllim, s'kam asnjë problem. Por ato leja që janë dhënë për hidrocentralet nuk ka dhënë asnjë, s'ka asnjë leje nga bashkia jonë. Janë dhënë që kur ishin komunat. Janë dhënë me vendim të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës. Dhe për situata emergjente të sasisë së rreshjeve që janë, mund të ketë efekte të dyanshme. Mund të kini të drejtë edhe ju. Nuk mund ta them, por mund të jetë edhe për efekt të sasisë së rreshjeve dhe këtë s'mund ta ndaj unë. E citova pak më parë, po e citoj përsëri. A kemi nevojë për ekspert? Patjetër që kemi. Dhe si institucion mund të kërkojmë që atë që kërkuam, siç thashë, për kakaçin edhe për vërçunin, ta kërkojmë edhe për zonën e mesmalit, nga studimi gjeologjik shqiptar. Për ta parë apo nga ekspertë të tjerë që mund të japin ide konkrete për këtë punë, shumë faleminderit. Po faleminderit, por që ta mbyll, të lutem, se më doli nga linja. Patjetër do jetë në vëmendjen tonë, edhe siç kemi filluar rehabilitimin e rrugës mes malit. Një ndërhyrje më e plotë për çakëllim të zonave dhe do të ndërhyjmë atë që kemi bërë në zona. Që kemi bërë në zona të tjera të Gorës, këtë vit kemi menduar që zonat që janë më problematike t'i betonojmë me beton, që të mos kemi mundësi që makinat të ngelen në zonat që kanë pjerrësi më të madhe.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Qyetari: Zoti kryetar, a ju duket normale juve që banorët në vitin dy mijë e njëzetë e katër, banorët e Selcës? Por edhe të veçantë kanë bërë dy rrugë paralele me fondet e tyre, me përpjekjet e tyre. Të mblidhen dhe sikur shteti nuk ekziston fare, a ju shqetësoni ju kjo gjë? Të cilat më shqetësojnë banorët? Juve?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Banorët në Vëlçan, në Vëlçan e ke? Po, po, në Vëlçan, në Vëlçan, bile i kam falenderuar kur e kanë marrë një nisje që kanë bërë një rrugë këtyre. Kemi ndërhyrë edhe ne në rrugën paralele me të, edhe për ata ju falenderoj, dhe i kemi falenderuar se ku ka më mirë të ketë dhe nisma të tillë që kanë mundësi banorët, se kjo s'do të thotë ndonjë gjë. Ndodh jo vetëm në, nuk ndodh vetëm aty, më fal, po edhe në fshatra të tjerë.

Qyetari: Kjo , po, u bë e modës, sepse këtu duket sikur shteti nuk ekziston fare. Atëherë unë po të shkoj, unë po të shkoj, unë po të shkoj, unë po të shkoj.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ne kemi nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë kilometra rrugë rurale, nëntëqind e pesëdhjetë. Nuk i bëjmë dot të gjitha. Të gënjejmë, nuk i bëjmë dot, por ne po themi t'i bëjmë të kalueshëm, nuk po themi t'i bëjmë asfalt, jo mo jo dakord, po sado t'i bëjmë, nuk i arrijmë dot. Ne kemi një fond vetëm gjashtë milionë lekë për rrugët dhe shtojmë pastaj të ardhurat tona me beton, me çakëll, me tombime, me të tjera. Kjo është mundësia financiare të gënjejmë njëri-tjetrin, nuk e gënjejmë dot. Urdhëro!

Qytetari: Ju përshëndes të gjithëve, quhem Arjan Agolli. Jam nga fshati Velçan, po banoj në Durrës. Kryetar, desha të bëja një pyetje, sepse të gjitha këto që dhanë këta janë të ezauruara për mua dhe nuk do t'i bie rrotull shumë kësaj. Po më duket se e mora përgjigjen. Juve thoni që nuk bëhet rruga në Belçan. Sfidoj çdo njeri nga ju këtu, që ka makinë. Rruga, rruga e veçantë, thoni juve, zbehtë, më fal, po me një sekondë, jo, jo, po të paktën të pranojmë atë, po ja sapo e thej. Nuk na pranë, nuk kemi fondet për t'i përballuar. Çdo njeri nga juve këtu, kush është, marrim makinat tashti dhe të ngjitemi nga tri urat për në Velçan. Se është vetëm pjesa e mes malit atje dhe e quajmë sikur çfarë po bëjmë atje, se unë e shoh edhe atje çfarë bëhet. Ja u bë edhe ajo pjesë atje, po pjesa që nga tre ura deri atje është copë-copë kryeta. Ti je i ndërgjegjshëm për këtë punë, se ke vajtur apo jo? Ne nuk mund të bëhet me ëndrra, jo për shembull, bëkemi një për të bërë një shollë. Fjala vjen, e bëjmë dot me themel atë rrugë me asfalt. Nuk e bëjmë, nuk e bëjmë dot kështu. Ja, kjo kaq, jo më kaq, që të zgjedhësh hallin dhe problemet e atij komuniteti, duhet të bëhet kështu. Pastaj, për të marrë një skavator. E për të hequr një baltë atje dhe për ta bërë super baltë, unë bëj, unë bëj, unë bëj, jam dakord moj, jam dakord, bëj ato që unë kam mundësi, jam dakord pra, tani unë nuk e kam zakon të të gënjej, jam dakord, këtë desha përgjigje, e bëjmë se bëjmë dot atë. Kështu pastaj, po të bëni aty, marri makinat edhe shkojmë andej.

Ornildi Demollari: Faleminderit për kohën juve. Atëherë, kryetar, kishe gjë? Jo, ecim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Iu shpjegoi banorëve të komunitetit të fshatit.Edhe mbas situatave të kohëve të fundit nëntor, por edhe janar, patjetër, dhe ne bëjmë analizat tona. Analizat tona, edhe të punës sonë, edhe të institucioneve të tjera që s'varen prej nesh, pasi e kam thënë edhe në takimet e mëparshme, po e citoj përsëri që situata e përmbytjeve është komplekse. Ka arsye të emergjencave që bien të rreshjeve, por ka arsye tek tuk edhe për mosfunksionim normal të shtetit. Për mungesë investimesh kapitale të thelluara ndër vite në argjinaturat e lumenjve. Në thellim të tyre, kështu që ne po shikojmë dhe patjetër ngrejmë zërin tonë atje ku është ngritur dhe besoj që viti që sapo kemi filluar. Do të ketë investime të konsiderueshme në thellimin. Në mbrojtjen lumore të lumit Devoll dhe Dunavec, dhe patjetër ne do të shikojmë me përparësi edhe problematikat të cilat na kanë lindur. Në zona rurale, siç është rasti konkret, për ta parë më me seriozitet tombino të ndryshme, zgjerime të mundshme apo betonime të zorrave që janë më problematike. Diçka duhet të jemi objektiv, pra të themi rruga e mes malit, që është aq e gjatë, por dhe e veçantë. Nuk mund, nuk mund të vihet, nuk mund të vihet me veturë. Nga këto të voglat për të gjithë periudhën e vitit. Të jemi, hajdeni ju, vëruni në vendin tim. Po të jemi objektiv për atë që kërkojmë, patjetër ne do të bëjmë maksimumin e mundshëm, por nëse në terren e të tilla të vështira. Nuk mund të vihet, po patjetër vihet me makina. Katër herë, katër vihet me furgon në këtë periudhë. Dhe ju duhet të na kërkoni neve vërtetë atë që duhet, që kemi dhe mundësi ta bëjmë.

Qytetari: Më faleminderit që më pranuat dhe dua të them dy gjëra nëse më lejoni. Faleminderit zotit kryetar, faleminderit që ju ta gjej sallës. Ëh, unë jam një pothuajse fshat fare, kam fshatin plotësisht dhe kam disa ankesa që mua nuk më pëlqejnë.

Ornildi Demollari: Si quhesh? Si quhet Mirela Maxhari?

Qytetari: Mirela Maxhari. Po, dhe jam drejtuar zotit kryetar, nëse më lejon. Me shumë kënaqësi, me shumë respekt, po i flas. Që unë jam duke dalë prej katër anëtarësh dhe jemi të gjithë pa punë, dhe jam prej katër anëtarëve me shumë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Tani nuk besoj, nuk besoj se ky, jo të lutem, të lutem. Po të lutem, ky, ky lloj diskutimi nuk është pjesë e kësaj. Po dakord, atëherë, kryetar, nuk e di a kemi gjë tjetër. Po.

Ornildi Demollari: Kemi një kërkesë, kemi një, kemi një kërkesë që ka ardhur në këshillë. Përshëndetje prej disa kohësh kemi hasur vështirësi në shërbimin e laboratorit nga qendra shëndetësore. Laboratorit për shkak të dëmtimeve të bëra të herë pas hershme të aparatit Bts 310. Aparati është riparuar disa herë, por aktualisht është i amortizuar plotësisht. Dhe nuk funksionon për shkak të një vjetërsie njëzetvjeçare në kushtet e mungesës së fondeve. Do ju luteshim të. Institucionit tuaj të na ndihmonit për procedurën e gjetjes në treg të një aparati më të avancuar dhe kostove financiare të tij. Laboratori është në shërbim një shërbim i rëndësishëm i qendrës shëndetësore, sepse lidhet drejtpërdrejt me diagnostifikimin e sëmundjeve akute dhe kontrollin e sëmundjeve kronike. Ju falenderoj për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj. Me respekt, zonja Eranda Dervishi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Por ne kemi, kjo kërkesë na ka ardhur edhe ne si. Po, si bashki, do ia propozojmë këshillit bashkiak që në buxhetin shtesë ne të blejmë një aparat të ri, patjetër më të avancuar. Dhe shpresojmë që Këshilli i Bashkisë ta miratojë në mbledhjen e radhës që do të miratojë buxhetin shtesë.

Ornildi Demollari: Dhe një kërkesë tjetër, faleminderit. Mbi administrimin e taksave vendore nëpërmjet agjentit tatimor, në mbështetjen e ligjit numër 139, dy mijë e pesëmbëdhjetë, për vetëqeverisjen vendore, neni gjashtë dhjetë e katër ligji numër nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy, datë tridhjetë i dhjetë i dy mijë e gjashtë, për sistemin e taksave vendore të ndryshuar, kreu shtatë neni tridhjetë e pesë tarifa vendore. Dhe administrimi i tyre, pika dy, ku thuhet se Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcakton nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat. bashkiake apo nga një agjent tatimor, bazuar në strukturën funksionale dhe paketën fiskale të miratuar, administrimi i taksave vendore realizohet nëpërmjet strukturave të bashkisë. Nga e cila rezulton se realizimi i planit të të ardhurave është në masën 60%. Në mënyrë që të rritet realizimi i planit të ardhurave, propozojmë që taksat vendore të arkëtohen nëpërmjet një agjenti tatimor. Nuk e kuptoj këtë inicialin kundrejt një përqindje të caktuar për shërbimin e kryer. Shoqëria rajonale e ujësjellës kanalizime Korçë. Mbulon me shërbim dhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë familje, ndërsa pjesa tjetër e familjeve që nuk mbulohen me shërbim nga ujësjellësi do të ndiqen nga strukturat e bashkisë për arkëtimin e vitit fiskal aktual, si dhe vlerën debitore. Për një mbledhje të të ardhurave sa më efikase, të cilat përkthehen në shërbime dhe punë publike, propozojmë që të

lidhim marrëveshje bashkëpunimi me një agjent tatimor për zgjedhjen e të cilit del. Për zgjedhjen e të cilit dhe lidhjen e kontratës e ka për detyrë funksionale kryetari i bashkisë. Përparësitë e mbledhjes së taksave vendore nëpërmjet agjentit tatimor janë si më poshtë një rritje e efikasitetit të arkëtimit, duke qenë të Se agjenti tatimor është më i specializuar, ka përvojë, si dhe detyrimi do të shtohet në faturën e ujit që i bëhet. Që e bën të detyrueshme pagesën e taksave vendore, dy detyrimi tatim paguese familjar do të jetë i përpjesëtuar në dymbëdhjetë muaj, e cila lehtëson barrën paguese të tyre. Tre rritje e numrit të taksapaguesve, pasi detyrimi për të paguar taksat dhe tarifat vendore do të kryhet për çdo familje. Të cilat janë identifikuar që disponojnë një pasuri të paluajtshme në Bashkimin Maliq, detyrohen të paguajnë tarifat lokale. Katër bashkia do të ulë shpenzimet për staf shtesë dhe pesë rritje e fokusit të bashkisë për realizimin e shërbimeve pub Është edhe kjo një kërkesë që na kishte erdhën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E fundit është në kuptim një miratim në parim që ne të biem të lidhim një akt marrëveshje, të biem dakord. Për modalitetet, pastaj do vijë patjetër projektvendimi në këshillë për përqindjen. Pse përqindja prej tyre lëviz nga dy deri në pesë për qind, dhe po negociojmë që përqindja të jetë sa më e ulët që ndërmarrja ujësjellësit do të marrë nga taksat tona. Dhe nga ana tjetër, bëjmë një. Shkojmë tek një njësim, siç e kanë bashkitë e tjera, të cilat kanë një përqindje më të lartë të vjeljes së të ardhurave vetëm nga kjo mënyrë. Dhe pastaj, unë mendoj që kjo do të jetë një nismë shumë efektive për të bërë të mundur edhe uljen në proçione të ulta për të gjithë qytetarët, të cilët ndonjëherë u duken shumë pagesat e menjëhershme të vitit buxhetor. Se sa ajo e ndarë në muaj, pavarësisht se vlera është e njëjtë, por e ndjejnë më pak si pagesë. Kjo është me pak fjalë.

Faslli Zholi: Po tashi në lidhje me atë zonjën atje ka një hall. Unë sot po e shikoj përreth, është vërtetë. Po nuk ka të drejtë kur ti ke prishur rrugën, atë avullinë se ke bërë rrugën. Kjo është e të gjitha. Shikoje atë problem, ta them personalisht, shikoje se ka një halle që vërtetë është, se është gjynah. Dhe shikoje që çfarë mund t'i bësh, po e them kështu. Sot po e shikoje, ta them sinqerisht, ose një fare. Po që shqetësimin që ngre, se njeriu kur ankohet, ka një gjë të shkaktë. Po, po jam tani të lutem. E kuptuam, do flasësh me kryetarin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Tashi do flasësh me atë të zyrës. Tani unë, unë dua të. Moj, hajde, hajde të shikojmë çfarë mundësi kemi të ndihmojmë, por nuk është dakord.

Ornildi Demollari:Të lutem, vazhdojmë tek informacioni tjetër.Informacion drejtuar Këshillit Bashkiak, Landa, kthim përgjigje mbi kërkesën për informacionin lidhur me procesin e dhënies së titujve të nderit. Festim, do na thuash diçka për këtë apo ta përcjell unë?

Pranvera Begolli: Është problemi i informacionit, aktualisht çfarë do bëhet? Pse po i shtyjmë kot profesori s'po e merr. Jo, ia kam dhënë fjalën festimit. Profesor Aliu s'po e merr akoma Sulejmani. T'ia japim këtë.

Ornildi Demollari: Po nëse do ta ndjekësh këtë, mund të largohesh atëherë.

Yllson Ibrahimllari: Profesor Gjergji Mërlika ishte në Tiranë, ishte me mua dhe me Zotin Kupe. E ka këtë zonjën që ka marrë inat sot nxënësen e vet. Ajo është nisma ime në propozimin e kemi kshpiedi. Të lutem, në propozimin që është bërë i nderuar kryetar, ose në informacionin që na sjell ky zoti, festim thuhet. Profesor Alire Fatllari, për arsye të ngarkesës së vet, nuk erdhi ta merrte titull. Jo, jo, të lutem, të lutem, më fal, të lutem, në fund e ke apo? Mund ta lexosh pro Sulejman Demollari Futbollist i njohur nuk erdhi në angazhimin. Kjo mund të jetë e drejtë, unë s'kam të vetë atë. Po e di, mo e di, po ka qenë i dalë foto dhe me ju të dy duke pirë kafe. Pra, ka qenë dakord. Profesor Gjergji Mylika, meqë jeton jashtë, e tjera. Tani ka një, ka një, ka një ndershmëri në marrëdhënien tonë. Propozimet i kemi bërë ne një grup këshilltarësh katërmbëdhjetë pesëmbëdhjetë tuajet tanët. Të paktën lajmërohet grupi që ka bërë propozimin dhe i thuhet. Ore, kam një vështirësi në komunikimin ndërmjet Zotit Gëzim dhe Zotit Yllson. A ma gjen një adresë kur do vijë? E dyta, më fal një sekondë, pse nuk këthen për mua? Pse nuk këthen përgjigje përsa i përket propozimit për Baba Kalenderin? Baba Hajdar Qosen, përsa i përket tashi Pipës, i kemi çuar andej. Na kanë ardhur përgjigjet, pra kjo përgjigje është e vakët. Jo e plotë dhe jo serioze, e bëhet me poetët Gorar. Nuk ftuat asnjëri si të tjerët, dhe ajo ceremoni nuk mbahet. Se mos dalë që kontribusi ishim ne, po them unë, kur ta marri titullin profesor Gjergji Mërlika, ta mbajë ose Petrit Kupja, ose Pranvera Begolli. Atëherë po, atëherësh mos na sjellin paçavure. Doktor, unë nuk kam nga këto. Ja ku e ke, lexoje se ka firmën tënde. Më fal, është jo në dinjitetin tënd të firmosi shkresa të tilla, se e ke firmosur ti në fund. Që nuk profesor Ali Refatllari për efekt të angazhimeve nuk ka ardhur ta marrë. Kurë e do ti, ndaje tashi sot në dymbëdhjetë natës. Ti solla unë të tretë ta marrin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: E cakto, atëherë cakto, caktoni datën. Bini dakord me atë që do të marrë titullin dhe ta bëjmë sa më parë.

Yllson Ibrahimllari: Jo, do të biem dakord që komisioni që ju drejtoni për dhënien e titullit të na japë edhe përgjigje. Pse nuk i jepet? Është propozimi jonë, baba kalenderit.

Petrit Kupe: Pse s'kemi asnjë përmendës që që ajo ato janë hedhur, janë lexuar. Gjitha ato kërkesat tuaja janë lexuar në komision, dhe komisioni nuk ka qenë dakord për dhëni. Kaq.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj, unë mendoj që propozuesit ndonjëherë, jo ndonjëherë, mirë është të jem prezent që të tregojmë pse e kam propozuar. Po duhet thirrur ata ju, ju kini anëtarë komisioni, kryetari i këshillit, sekretari i këshillit më fal. E di dhe të njoftoj, o doktor, do mblidhet komisioni i kësaj pune. Nuk them vetëm këtë rast, nuk dua të dal vetë nga situata për këtë situatë. Por që këto duhen bërë dhe duhet të ketë seriozitet, si në kthim përgjigje, si për t'i realizuar. Kjo është haja e çdo gjëje, është haja. Kështu që jam i hapur, doktor, caktoni datën të marrim nismën për të dy rastet, edhe për temollarin, edhe për profesorin. Dua të theksoj që mos vendos unë datë kot, pesëmbëdhjetë shkurti. Realizoje sa më parë.

Ornildi Demollari: Dua të theksoj që me Sulejman Demollarin kam komunikuar unë, pasi kam lidhje familjare dhe kaq e ka pasur vërtetë të pamundur të vinte. Tani do ta sjellë Doktor Elsoni

këtë radhë kur ta njoftojmë. Faleminderit. Tani të tre do t'i sjell, do t'i sjell të tre. Me Sulejman Demollarin kam komunikuar unë dhe e ka pasur të pamundur.

Yllson Ibrahimllari: Jo, jo, ti. I ke detyrimin kur, kur bën promovimin e titujve të nderit me Sulejman dhe molla të poetëve Gorar, të ftosh lulin me Selon mua. Edhe Petrit Kupen dhe kushdo që është këshilltar që ka lidhje me atë zonë, dhe ti e ke shkelur. E lëre ironinë, me si element demollarin, jo, me si element demollarin, jo, i ke ti, edhe ti në tene. Është e vërtetë që e ka pasur të pamundur të vinte. Shih. Erdha dhe ditën e premte për mbledhjet e komisionit të mandateve dhe u lajmërova në ora njëmbëdhjetë që zonja ishte e sëmurë me zjarrin e natës. Ju lutem, se s'më lajmëronin dot një ditë para. Faleminderit, ju lutem.

Gentiana Drabo:Është e mira të përcaktohet një datë që ne të bëjmë përgatitjet për në katërmbëdhjetë shkurt, nëse shihni të zëmë për aktivitetin. Po atëherë, ja që them një, një, një, një, një, një numër. Problemi është që ne të kemi kohë për të bërë aktivitetin.

Ornildi Demollari: Ju lutem, kalojmë tek pika tjetër, raport mbi vendimarrjen dhe performancën e Këshillit të Bashkisë Maliq për vitin 2025. Është e nevojshme ta lexojmë, ju e keni të gjithë përpara. Tani e fundit është, është ky zotëria këtu i Çaushlisë, kryetar. Nuk e di, do ta takosh kur të dalësh. Edhe Reizi për të. Shumtën herë, këta të flas për një minutë, po pranvera ke fjalë.

Pranvera Begolli: Më falni, meqënëse kam qenë pjesë e institucionit të kombinatit të sheqerit, aktualisht është krijuar një ngësh për moskrijimin e këshillit mbikëqyrës. Për arsye se s'po jap, s'po jepet dot as kërkesa për të dhënë me qira, as të procesit të privatizimit nga subjektet që janë atje. Ju lutem, jini vënë në dijeni edhe ju.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne e kemi mbyllur e kemi pezulluar këtë me vendim këshilli ose asamblesë çaresh.

Yllson Ibrahimllari: Po ta përsërit kryetar dhe jam pro teje, po të them atë fjalë që i tha Regan Gorbaçovit, shembe atë mur. Hajde të marrim masat ligjore, siç do rregulloni rregulloren. Hiqemi atë paçavure.

Pranvera Begolli: Duhet patjetër këshilli mbikëqyrës që të bësh procedurat. Pa këshilli mbikëqyrës, nuk bëhen procedurat.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:I shpjeguar njëherë me gjithë këshilli i bashkisë, në momentin që jeni gati për të kaluar në të. Likuidim dhe mbyllje në asaj, ne jemi të gatshëm ta ngrejmë atë, të merret kjo vendimarrje dhe ta mbyllim. Kaq kemi thënë. Ne s'mund të paguajmë një bord drejtues, muaj për muaj, pa bërë asgjë.

Yllson Ibrahimllari: Kishim lekë për ekspertët, për banorët, që të vesh t'i paguash një inxhinieri hidro, për ç'a shkaku ka vajtur. Dhe paguajmë referencat. Atë, atë, ai ta marrim. Po patjetër që do

ta marrim, do ta marrim me kështu, dhe bile është hera e parë që kryetari i këshillit ka goditur në shenjë. Unë vetëm për këtë punë kam ardhur në këshill.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jemi dakord për atë pjesë, tani të ndajmë për çfarë ke ardhur për punët e tua personale.

Yllson Ibrahimllari: Jo, unë mendoj të mos i hysh kësaj pjese, se nuk del mirë. Të lutem, nuk del mirë.

Pranvera Begolli: Pjesën e titujve, ja përse duhet ai. Aktualisht është bërë dhe një kërkesë për marrje me qira. Mund të marrit një vendim se këshilli mbikëqyrës dhe për likuidimin duhet patjetër të jetë në procedurë. Mund të merret një vendim nga asambleja që ai të paguhet vetëm për mbledhje.

Yllson Ibrahimllari:O, jo, i kam qënë nëntëdhjetë e dy.Të atij këshilli të firmosura nga kujt i modës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë, unë ju falenderoj shumë, po ju jap një kështu. Do desha që në të gjithë takimet, miku i festimit, Gerti, të gjitha takimet. Po në këtë komision, besoj, janë dhe anëtarët e këshillit.Ka edhe opozita dhe mazhoranca. Ata të njoftojnë edhe propozuesit që të jenë atje. Biles, e kini detyrim që çdo rast që ne hapim tituj, ku ka më mirë që aty të jenë të gjithë anëtarët e këshillit të bashkisë. S'ka më mirë, patjetër, patjetër, kemi nevojë edhe ne, po ju shpjegoj. Edhe ne kemi nevojë që të jeni pjesë e kësaj salle, kur jepen tituj. Dhe nuk unë të paktën nuk kam ndonjë.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë ç'mund të ma thoni ça personale është vlerësimi i figurës së profesor Gjergji Mëlikës? Asgjë pra, asgjë. Të lutem, unë e di që të gjithë këtë grup e të gjithë këta këshilltarë i komandon ti. Do t'i thashë të rinj me edukatë, sa mos më erdhi. Unë jam nga ata fisë që po u preka me dorë. Ndua zvarrë, mund të më hiqni, të më vrisni, po jo, lëri ironitë e këtyre.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Doktor, këtë fjali, pasi secili këshilltar ka personalitetin e vet, siç kanë dhe tuajt andej. Që e respektoj edhe në mendim dhe ashtu, ne jemi shumë dakord që të jemi sa më konsensual për çdo veprim që ne marrim për të mirën. Jo, jo, jo, jo, jo, jo, jo, s'kam asgjë. Dhe jam shumë dakord që ne të marrim edhe për atë problem që ndoshta ti mund të mund të reagosh. Të marrim, të marrim dy ekspertë. Dhe ta shikojmë të gjithë situatën në vend, se na shërben edhe ne dhe juve. S'kam asnjë gjë për atë dhe për titujt e nderit. Unë kam asnjë gjë, bile e vlerësoj maksimalisht profesorin dhe hajt ta bëjmë sa më parë, jo vetëm atë, por të gjithë figurat që ka territori jonë për t'i bërë sa më parë dhe për ta rritur edhe prestigjin e institucionit. Shumë faleminderit të gjithëve.

Ornildi Demollari: Faleminderit, e mbyllim këtë pjesë.Kjo ishte mbledhja.Faleminderit!

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI